

RAPORTI FINAL

MODELI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE ME NË QENDËR QYTETARIN NË SHQIPËRI

Vlerësimi Final

IDRA Research & Consulting

MODELI i OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE ME NË QENDËR QYTETARIN NË SHQIPËRI

VLERËSIMI FINAL

Raporti Final

Ky draft raport final paraqet dhe përmbledh gjetjet tona, dhe përmban një analizë të detajuar të rezultateve.

25 Nëntor 2020

Përmbajtja

1	Përmbledhje Ekzekutive	1
1.1	Hyrje	2
1.2	Përmbledhja e gjetjeve të studimit.....	4
1.2.1	Aksesi në shërbimet publike.....	4
1.2.2	Treguesit kryesore të projektit	5
1.2.3	Vlerësimi i shërbimeve publike.....	9
1.2.4	Përvoja dhe perceptimi i korrupsionit	10
1.2.5	Shërbimet elektronike & kanalet e preferuara të komunikimit.....	11
1.2.6	Përmbledhje e gjetjeve cilësore.....	13
2	Metodologjia.....	15
2.1	Institucionet publike të përfshira në studim.....	16
2.2	Qasja e përgjithshme	17
2.3	Metodologjia e studimit.....	17
2.3.1	Metodologjia e kampionimit	18
2.3.2	Metodologjia e kampionimit - Kampioni shtesë Romë / Egjiptian	22
2.4	Procedurat e llogaritjes së indeksit të pasurisë, peshimi, dhe profili i të intervistuarve	23
2.4.1	Llogaritja e Indeksit të Pasurisë	23
2.4.2	Procedura e peshimit.....	25
2.4.3	Shkalla matëse e përdorur	25
2.5	Profili i kampionit.....	26
2.6	Organizimi i Grupeve të diskutimit.....	28
3	Indikatorët Kryesorë të Studimit.....	30
3.1	Aksesi në Institucione	31
3.1.1	Nevoja për shërbime dhe kontakti me institucionet publike.....	31
3.1.2	Kontakti me institucionet publike	33
3.1.3	Aksesi në shërbimet elektronike	38
3.1.4	Aksesi në shërbimet elektronike: gjetjet cilësore	43

3.2	Aksesimi i shërbimeve publike	47
3.2.1	Aksesimi i shërbimeve publike sipas indeksit të pasurisë.....	47
3.2.2	Aksesimi i shërbimeve publike sipas gjinisë, zonës dhe moshës.....	48
3.2.3	Aksesimi i shërbimeve publike: Popullsia Rome	51
3.2.4	Aksesimi i shërbimeve publike: rezultate shtesë.....	52
3.2.5	Aksesimi i shërbimeve publike: gjetjet cilësore	56
3.3	Kënaqësia me shërbimet publike	59
3.3.1	Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas indeksit të pasurisë.....	60
3.3.2	Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas gjinisë, zonës së banimit dhe moshës	61
3.3.3	Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike: Komuniteti Rome.....	63
3.3.4	Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike: çështje të mëtejshme.....	64
3.3.5	Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike: gjetjet cilësore	66
4	Përvoja me Institucionet Publike	69
4.1	Vlerësimi i attributeve të shërbimit.....	70
4.1.1	Vlerësimi i përgjithshëm i attributeve	70
4.1.2	Transparenca.....	73
4.1.3	Përgjegjësia.....	74
4.1.4	Drejtësia / Paanësia	75
4.1.5	Shpejtësia e përpunimit të procedurave	76
4.1.6	Saktësia e shërbimit	77
4.1.7	Lexueshmëria e formularëve	78
4.1.8	Përshtatshmëria e orarit të punës dhe e vendndodhjes së zyrës.....	79
4.1.9	Sjellja dhe komunikimi i stafit.....	81
4.2	Përvoja me ankesat.....	82
4.2.1	Arsyet për tu ankuar.....	82
4.2.2	Ankesat e bëra	84
4.2.3	Përvoja me ankesat: gjetjet cilësore.....	85
4.3	Përvoja me korrupsionin	87
4.3.1	Përvoja personale me korrupsionin.....	87
4.3.2	Perceptimi i korrupsionit	88
4.3.3	Përvoja me korrupsionin: gjetjet cilësore.....	93

4. Informacioni dhe Komunikimi.....	95
4.4 Përdormi i teknologjisë së informacionit.....	96
4.4.1 Aksesi në internet dhe teknologjinë e informacionit	96
4.4.2 Përdorimi i internetit	98
4.5 Informacioni dhe kanalet e komunikimit.....	105
4.5.1 Aksesi te financat	105
4.5.2 Përvoja me disponueshmërinë e informacionit nga institucionet publike	106
4.5.3 Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike	110
5 Aneks.....	113
5.1 Rezultatet kryesore për institucionet në fokus	114
5.1.1 Aksesi në shërbimet publike.....	114
5.1.2 Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike.....	117
5.1.3 Vlerësimi i attributeve	119
5.1.4 Eksperienca me korrupsionin.....	123
5.2 Profili i të anketuarve (i papeshuar).....	125
5.3 Profili i indeksit të pasurisë.....	126
5.4 Rezultate shtesë	128
5.4.1 Institucionet e aksesuara.....	128
5.4.2 Aksesi drejt informacionit dhe teknologjisë.....	133
5.4.3 Struktura e indeksit të pasurisë.....	140

Lista e Figurave

Figura 1: Llogaritja e Indeksit të pasurisë përmes metodës së Analizës së Komponentit Kryesor	24
Figura 2: Transformimi i shkallës matëse	25
Figura 3: Gjinia e të anketuarve	26
Figura 4: Zona e të anketuarve.....	26
Figura 5: Moshja e të anketuarve	27
Figura 6: Arsimi i të anketuarve	27
Figura 7: Statusi i punësimit të të anketuarve	27
Figura 8: Kontakti me të paktën një institucion – popullsia e përgjithshme sipas indeksit të pasurisë	33
Figura 9: Kontakti me të paktën një institucion – popullsia e përgjithshme sipas indeksit të pasurisë (përfshirë pjesën e të anketuarve që deklaruan kontaktimin përmes një pjesëtari të familjes për llogari të tyre).....	34
Figura 10: Kontakti me të paktën një institucion – Popullsia Rome.....	34
Figura 11: Mesatarja e kontakteve ballë për ballë për çdo institucion, e peshuar me numrin e kontakteve për çdo institucion	35
Figura 12: Kontakti ballë për ballë për shumicën e institucioneve*	35
Figura 13: Arsyeja për kontaktin ballë për ballë (shumë përgjigje).....	35
Figura 14: Krahasimi i kontaktimit të institucioneve përmes ADISA-s	36
Figura 15: Metoda e kontaktit nga institucioni	36
Figura 16: Roli i ADISA’s gjatë kontaktimit	36
Figura 17: Kontakti përmes ndërmjetësve	37
Figura 18: Llojet e ndërmjetësve (N=59) -me shumë përgjigje.....	37
Figura 19: Niveli i njohurive lidhur me shërbimet elektronike të ofruara nga një entitet publik ose privat	38
Figura 20: Niveli i njohurive lidhur me shërbimet elektronike krahasuar sipas valëve (popullsia në total dhe popullsia e varfër)	38
Figura 21: Krahasimi i nivelit të njohurive lidhur me shërbimet elektronike ndërmjet grupeve të ndryshme	38
Figura 22: Aksesit në shërbimet elektronike sipas valëve (përqindja e të anketuarve që kishin dijeni lidhur me shërbimet elektronike).....	39
Figura 23: Aksesit në shërbimet elektronike publike dhe private (vetëm nëse i anketuari kishte dijeni për shërbimet elektronike – total N=1327).....	39
Figura 24: Lloji i shërbimit elektronik të aksesuar	40
Figura 25: Përqindja e të anketuarve në total (N=2001) të cilët kanë aksesuar “e-Albania” gjatë 12 muajve të fundit.....	40

Figura 26: Përqindja e të anketuarve QË KANË KONTAKTUAR TË PAKTËN NJË INSTITUCION dhe kanë aksesuar “e-Albania” (në vlerësimin Final të anketuarit të cilët e kanë përdorur atë VETËM për të marrë leje për të dalë nga shtëpia, etj. gjatë mbylljes së COVID – 19, janë përjashtuar).....	40
Figura 27: : Përqindja e të anketuarve në TOTAL që kanë aksesuar “e-Albania” (në vlerësimin Final të anketuarit të cilët e kanë përdorur atë VETËM për të marrë leje për të dalë nga shtëpia, etj. gjatë mbylljes së COVID – 19, janë përjashtuar)	40
Figure 28: Shpërndarja e aksesit në e-Albania (të anketuarit QË KANË KONTAKTUAR TË PAKTËN NJË INSTITUCION) ndërmjet grupeve të ndryshme	41
Figura 29: A e përdorët “e-Albania” personalisht apo ju ka ndihmuar dikush tjetër ? (gjithë përdoruesit e “e-Albania”).....	42
Figura 30: A e përdorët “e-Albania” personalisht apo ju ka ndihmuar dikush tjetër ? (duke përjashtuar të anketuarit që e përdorën atë VETËM për të marrë leje për të dalë nga shtëpia etj. gjatë mbylljes së COVID -19).....	42
Figura 31: Cila është arsyeja që ju është nevojitur ndihmë për të aksesuar “e-Albania”? (lejohen shumë përgjigje)	42
Figura 32: Lehtësia e aksesimit / përdorimit të “e-Albania”*	43
Figura 33: Kënaqësia me “e-Albania”*	43
Figura 34: Indikator i aksesimit të shërbimeve publike sipas indeksit të pasurisë.....	47
Figura 35: Indikator i aksesimit të shërbimeve publike sipas gjinisë.....	49
Figura 36: Indikator i aksesimit të shërbimeve publike sipas zonës.....	50
Figura 37: Indikator i aksesimit të shërbimeve publike sipas moshës	50
Figura 38: Indikator i aksesimit të shërbimeve publike: Popullsia Rome sipas gjinisë.....	51
Figura 39: Krahasimi i aksesimit: aksesit përmes ADISA	52
Figura 40: Aksesimi i shërbimeve publike sipas qarkut.....	53
Figure 41: Shërbimet e nevojshme që nuk janë aksesuar (nuk janë kontaktuar).....	54
Figura 42: Përse nuk e keni kontaktuar institucionin për shërbimin e nevojshëm? (lejohen shumë përgjigje)	55
Figura 43: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas indeksit të pasurisë.....	60
Figura 44: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas gjinisë.....	61
Figura 45: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas zonës së banimit	62
Figure 46: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas moshës	62
Figura 47: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas gjinisë – Popullsia Rome	63
Figura 48: Krahasimi i nivelit të kënaqësisë me shërbimet publike, akses vetëm përmes ADISA.....	64
Figura 49: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas qarkut	65
Figura 50: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas institucioneve	66
Figura 51: Vlerësimi i atributëve	70

Figura 52: Si u informove mbi procedurën e përdorimit të shërbimit? (Përgjigje e shumëfishtë) – Popullsia e përgjithshme	71
Figura 53: Si u informove mbi procedurën e përdorimit të shërbimit? (Përgjigje e shumëfishtë) – Sipas kategorive.....	72
Figura 54: Vlerësimi i transparencës – popullsia e përgjithshme dhe e varfër	73
Figura 55: Vlerësimi i përgjegjësisë – popullsia e përgjithshme dhe e varfër.....	74
Figura 56: Vlerësimi i drejtësisë – popullsia e përgjithshme dhe e varfër	75
Figura 57: Vlerësimi i shpejtësisë së përpunimit të procedurave – popullsia e përgjithshme dhe e varfër.....	76
Figura 58: Vlerësimi i saktësisë së shërbimit – popullsia e përgjithshme dhe e varfër	77
Figura 59: Vlerësimi i lexueshmërisë së formularëve – popullsia e përgjithshme dhe e varfër	78
Figura 60: Vlerësimi i orarit të përshtatshëm të punës – popullsia e përgjithshme dhe e varfër.....	79
Figura 61: Vlerësimi i vendndodhjes së zyrave – popullsia e përgjithshme dhe e varfër	80
Figura 62: Vlerësimi i sjelljes dhe komunikimit të stafit.....	81
Figura 63: A keni pasur ndonjë arsye për t'u ankuar? (Vetëm ata që kanë kontaktuar të paktën një institucion)	82
Figura 64: A keni pasur ndonjë arsye për t'u ankuar? – E ndarë sipas institucioneve (Vetëm ata që kanë kontaktuar të paktën një institucion).....	83
Figura 65: Numri i rasteve kur qytetarët kanë paraqitur një ankesë	84
Figura 66: Pse nuk paraqite një ankesë nëse kishe arsye për ta bërë diçka të tillë?.....	84
Figura 67: Platforma e bashkëqeverisjes "Shqipëria që duam"	85
Figura 68: Gjatë kontaktit tuaj me institucionin, është nënkuptuar (ose u është kërkuar) në ndonjë moment që ju duhet të jepnit ryshfet për të marrë shërbimin?	87
Figura 69: Për çfarë qëllimi është paguar ryshfeti? (Ilejohet shumë përgjigje)	88
Figura 70: Eksperienca me korrupsionin sipas kontaktit.....	88
Figura 71: Si do ta vlerësonit nivelin e korrupsionit në institucione? – Sipas përvojës me korrupsionin... ..	89
Figura 72: Si do ta vlerësonit nivelin e korrupsionit në këtë institucion (Nëse e keni kontaktuar ose jo) ? ..	90
Figura 73: Përqindja e vlerësimeve "të larta" dhe "shumë të larta" të nivelit të korrupsionit në institucion (duke marrë parasysh vetëm përgjigjet e kualifikuara).....	91
Figura 74: Vlerësimi i korrupsionit nga të anketuarit të cilët kanë pasur kontakt me të paktën një institucion	92
Figura 75: Vlerësimi i korrupsionit nga të anketuarit të cilët nuk kanë pasur kontakt me një institucion ..	92
Figura 76: Ku e bazoni vlerësimin tuaj për korrupsionin? (Ilejohet shumë përgjigje).....	93
Figura 77: Aksesit në Internet – krahasimi	96
Figura 78: Aksesit në internet – sipas indeksit të pasurisë.....	96
Figura 79: Aksesit në Internet, Popullsia Rome – krahasimi	96
Figura 80: Aksesit në internet – sipas zonës.....	97

Figura 81: Aksesit në internet – sipas moshës	97
Figura 82: A keni ju një smartphone? – Krahasim.....	97
Figura 83: A keni ju një smartphone? –sipas indeksit të pasurisë	97
Figura 84: A keni ju një smartphone? Popullsia Rome - Krahasim.....	98
Figura 85: A keni ju një smartphone? - sipas zonës së banimit	98
Figura 86: A keni ju një smartphone? – sipas moshës	98
Figura 87: A e përdorni internetin? – Krahasim	99
Figura 88: A e përdorni internetin? – sipas indeksit të pasurisë.....	99
Figure 89: A e përdorni internetin ? Popullsia Rome- Krahasim	99
Figura 90: A e përdorni internetin? – Sipas zonës së banimit.....	99
Figura 91: A e përdorni internetin? – Sipas moshës	99
Figura 92: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? - Krahasim.....	100
Figure 93: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – Sipas indeksit të pasurisë	100
Figura 94: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? Popullsia Rome - Krahasim	100
Figura 95: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – Sipas zonës së banimit	101
Figura 96: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – Sipas moshës	101
Figura 97: Ku e përdorni internetin? (Vetëm ata që e përdorin internetin – me shumë përgjigje).....	101
Figura 98: Ku e përdorni internetin? (Vetëm ata që e përdorin internetin – me një përgjigje).....	102
Figura 99: Sa shpesh, në 12 muajt e fundit, keni përdorur internetin për qëllimet e mëposhtme? (Vetëm ata që përdorin internetin)	104
Figura 100: A keni ju ose një pjesëtar tjetër i familjes tuaj ...?	105
Figura 101: Kanë pasur vështirësi në marrjen e informacionit - Krahasim	106
Figura 102: Kanë pasur vështirësi në marrjen e informacionit – Sipas zonës së banimit	106
Figura 103: Vështirësitë e hasura në marrjen e informacionit – Krahasim	107
Figura 104: Vështirësitë e hasura në marrjen e informacionit – Sipas moshës	107
Figura 105: Vështirësitë e hasura në marrjen e informacionit – Sipas nivelit të arsimit	107
Figura 106: E Vështirësitë e hasura në marrjen e informacionit – Sipas indeksit të pasurisë.....	107
Figura 107: Vështirësitë në marrjen e informacionit të nevojshëm	108
Figura 108: <i>A hasët vështirësi në marrjen e informacionit të nevojshëm për çdo të shërbim publik që ju duhej në 12 muajt e fundit? Popullsia Rome (N=200)</i>	108
Figura 109: Nga cilat kanale komunikimi preferoni të merrni informacion mbi shërbimet publike? – Krahasuese	109
Figura 110: Nga cilat kanale komunikimi preferoni të merrni informacion mbi shërbimet publike? – Sipas gjinisë dhe zonës së banimit	109

Figura 111: Çfarë mendoni se mund të përmirësohet në ofrimin e shërbimeve publike? – Popullsia e përgjithshme	110
Figura 112: Çfarë mendoni se mund të përmirësohet në ofrimin e shërbimeve publike? – Popullsia Rome	111
Figura 113: Çfarë mendoni se mund të përmirësohet në ofrimin e shërbimeve publike? – Popullsia e varfër	112
Figura 114: Indikator i aksesit ndaj shërbimeve publike për institucionet në fokus sipas indeksit të pasurisë	115
Figura 115: Indikator i aksesit ndaj shërbimeve publike për institucionet në fokus sipas gjinisë	115
Figura 116: Indikator i aksesit ndaj shërbimeve publike për institucionet në fokus sipas zonës së banimit	115
Figura 117: Indikator i aksesit ndaj shërbimeve publike për institucionet në fokus sipas moshës	116
Figure 118: Indikator i aksesit ndaj shërbimeve publike për institucionet në fokus – popullsia Rome sipas gjinisë	116
Figura 119: Indikator i aksesit ndaj shërbimeve publike për institucionet në fokus – popullsia Rome sipas zonës së banimit	116
Figura 120: Indeksi i "Kënaqësisë me shërbimet publike nga institucionet në fokus" sipas indeksit të pasurisë	117
Figura 121: Indeksi i "Kënaqësisë me shërbimet publike nga institucionet në fokus" sipas gjinisë	117
Figura 122: Indeksi i "Kënaqësisë me shërbimet publike nga institucionet në fokus" sipas zonës së banimit	117
Figura 123: Indeksi i "Kënaqësisë me shërbimet publike nga institucionet në fokus" sipas moshës	118
Figura 124: Indeksi i "Kënaqësisë me shërbimet publike nga institucionet në fokus" – Popullsia Romë sipas gjinisë	118
Figura 125: Indeksi i "Kënaqësisë me shërbimet publike nga institucionet në fokus" sipas – Popullsia Romë sipas zonës së banimit	118
Figura 126: Vlerësimi i përgjithshëm i atributëve për institucionet në fokus	119
Figura 127: Vlerësimi i transparencës (për institucionet në fokus)	119
Figura 128: Vlerësimi i përgjegjshmërisë (për institucionet në fokus)	120
Figura 129: Vlerësimi i paanësisë (për institucionet në fokus)	120
Figura 130: Vlerësimi i shpejtësisë së procesimit (për institucionet në fokus)	120
Figura 131: Vlerësimi i saktësisë së dhënies së shërbimit (për institucionet në fokus)	121
Figura 132: Vlerësimi i lexueshmërisë së formularëve (për institucionet në fokus)	121
Figura 133: Vlerësimi i përshtatshmërisë së orareve të zyrës (për institucionet në fokus)	121
Figura 134: Vlerësimi i përshtatshmërisë së vendndodhjes së zyrës (për institucionet në fokus)	122
Figura 135: Vlerësimi i sjelljes së stafit dhe komunikimi (për institucionet në fokus)	122

Figura 136: Gjatë kontaktit tuaj me institucionin, është nënkuptuar (ose kërkuar) në ndonjë moment dhënia e ryshfetit për të marrë shërbimin?	123
Figura 137: Si do ta vlerësonit nivelin e korrupsionit në këto institucione? Vetëm ata që vlerësuan me «të lartë» dhe «shumë të lartë»(duke marrë parasysh vetëm përgjigjet e kualifikuara).....	123
Figura 138: Si do ta vlerësonit nivelin e korrupsionit në këto institucione? (Nëse është kontaktuar ose jo)	124
Figura 139: Zona e banimit (e papeshuar)	125
Figura 140: Gjinia e të anketuarve (e papeshuar).....	125
Figura 141: Moshja e të anketuarve (e papeshuar)	125
Figura 142: Arsimi i të anketuarve (i papeshuar)	125
Figura 143: Statusi i punësimit (i papeshuar).....	125
Figura 144: Pajisjet në pronësi	126
Figura 145: Profili Bankar	126
Figura 146: Profili i indeksit të pasurisë – vetëm rastet kur më pak se 20% e shtresës së varfër zotëron asetet përkatëse.....	127
Figura 147: Të ardhurat e familjes – sipas rajonit dhe zonës së banimit	127
Figura 148: Institucionet e aksesuara – kontakti personal.....	128
Figura 149: Institucionet e aksesuara – të kontaktuara personalisht ose nga një anëtar i familjes	129
Figura 150: A e morët më në fund shërbimin ?	130
Figura 151: A ishte e lehtë për ju të merrnit informacionin për shërbimin publik të kërkuar?	130
Figura 152: Si e keni mësuar procedurën në lidhje me marrjen e shërbimit? (Me shumë përgjigje)	131
Figura 153: Aksesit në internet sipas statusit të punësimit.....	133
Figura 154: Aksesit në internet – sipas rajonit	133
Figura 155: Aksesit në internet – sipas zonës.....	133
Figura 156: A keni ju një “smartphone”? – sipas statusit të punësimit	134
Figura 157: A keni ju një “smartphone”? – sipas rajonit.....	134
Figura 158: A keni ju një “smartphone”? – sipas zonës së banimit	134
Figura 159: A e përdorni internetin ? – sipas statusit të punësimit	135
Figura 160: A e përdorni internetin ? – sipas rajonit	135
Figura 161: A e përdorni internetin ? – sipas zonës së banimit	135
Figura 162: A keni ndërmend që të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – sipas statusit të punësimit	136
Figura 163: A keni ndërmend që të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – sipas rajonit	136
Figura 164: A keni ndërmend që të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – sipas zonës së banimit.....	136

Figura 165: Sa shpesh e keni përdorur internetit, gjatë 12 muajve të fundit, për qëllimet e mëposhtme? – sipas gjinisë dhe moshës.....	137
Figura 166: Sa shpesh e keni përdorur internetit, gjatë 12 muajve të fundit, për qëllimet e mëposhtme? – sipas rajonit dhe zonës së banimit.....	138
Figura 167: A përjetuat vështirësi në marrjen e informacionit të nevojshëm për çdo të shërbim publik që ju duhej në 12 muajt e fundit? – sipas arsimit.....	138
Figura 168: A përjetuat vështirësi në marrjen e informacionit të nevojshëm për çdo të shërbim publik që ju duhej në 12 muajt e fundit? – sipas statusit të punësimit.....	139
Figura 169: Nga cilat kanale komunikimi preferoni të merrni informacion mbi shërbimet publike? - Sipas arsimit (Me shumë përgjigje).....	139

Lista e Tabelave

Tabela 1: Institucionet publike të përfshira në studim.....	16
Tabela 2: Shpërndarja e kampionit rom.....	23
Tabela 3: Shpërndarja e intervistave.....	26
Tabela 4: A keni pasur nevojë të merrni ndonjë shërbim nga institucionet e mëposhtme gjatë 12 muajve të fundit, edhe nëse nuk i keni kontaktuar ato në në fund? (<i>Popullsia e përgjithshme</i>).	31
Tabela 5: A keni pasur nevojë të merrni ndonjë shërbim nga instiucionet e mëposhtme gjatë 12 muajve të fundit, edhe pse nuk e keni kontaktuar atë në fund ? (<i>Popullsia Rome</i>).....	32
Tabela 6: Struktura e indeksit të pasurisë.....	140

1 Përmbledhje Ekzekutive

1.1 Hyrje

Qeveria e Shqipërisë është e vendosur të ndryshojë rrënjësisht mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në Shqipëri përmes një sërë ndërhyrjesh me në qendër qytetarin, të cilat luftojnë korrupsionin, nxisin një kulturë të kujdesit ndaj klientit, rrisin aksesin, si dhe rrisin efikasitetin në administratën publike shqiptare.

Nën prioritetin e Qeverisjes së Mirë Inovative, të nisur në Prill 2014, programi “Inovacioni kundër Korrupsionit: Ndërtimi i një Modeli të Ofrimit të Shërbimeve me në qendër Qytetarin në Shqipëri” (ISDA), i udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIPA), përfshin një reformë shumëpalëshe e cila fokusohet në shërbimet publike kryesore të qeverisë qendrore për të reduktuar kohën dhe barrën për qytetarët dhe bizneset dhe për të përmirësuar cilësinë, transparencën dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve duke përdorur zgjidhje inovative dhe TIK.

Shtyllat e saj kryesore janë:

- Krijimi dhe menaxhimi i një modeli të integruar mbarëkombëtar të ofrimit të shërbimeve me anë të të cilit zyra pritëse është e përqendruar në raportin me publikun dhe është e ndarë nga zyrat mbështetëse, duke përfshirë implementimin e zyrave me një ndalesë dhe qasjes në-një-vend të Qendrës së Shërbimit për Qytetarët;
- Standardizimi i ofrimit të shërbimeve, thjeshtëzimi përmes ri-inxhinierimit dhe dixhitalizimit të procesit të biznesit, me fokus në shërbimet online;
- Reagimi i qytetarëve dhe monitorimi i performancës për ofrimin e shërbimeve për përmirësim të vazhdueshëm.

Në Tetor 2014, ADISA, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara në Shqipëri, u krijua për të menaxhuar shpërndarjen e centralizuar të shërbimeve publike për qytetarët. Mandati i saj i zgjeruar përfshin zbatimin e ndarjes së sporteleve pritëse (FO) nga zyrat mbështetëse (BO) në të gjitha institucionet qendrore. Ky proces përfshin rinovimin e ofrimit të shërbimeve publike në Shqipëri me vendosjen e standardeve të shërbimit për qytetarët dhe monitorimin e performancës për nëpunësit e sporteleve të shërbimit, bazuar në një kulturë të kujdesit ndaj klientit. Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore për projektin e Ofrimit të Shërbimeve Publike me në qendër Qytetarin, ku ADISA ishte agjenci përfituese dhe përgjegjëse për zhvillimin e të gjitha aspekteve teknike të projektit.

Që nga ngritja e sportelit të tij të parë në Zyrën e ZRPP-së në Tiranë në vitin 2015, ADISA është zgjeruar në të gjithë vendin përmes hapjes së Qendrave të Integruara të Ofrimit të Shërbimit (qendra me një ndalesë) ose qendra të kolokuara në bashki të ndryshme të vendit. Deri në fund të vitit 2019, ADISA ishte e pranishme në 14 vendndodhje në rreth 13 qytete, me 2 qendra në Tiranë (Tirana 1¹, Tirana 2), dhe nga 1 qendër në Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Kavajë, Krujë, Kukës, Maliq, Belsh, Patos, Librazhd, Divjakë dhe Malësi e Madhe. Gjatë pjesës së parë të vitit 2020, ADISA hapi 2 qendra të tjera të integruara në Lushnjë dhe Elbasan.

¹ Kjo zyrë ishte mbyllur për 6 muaj për shkak të dëmtimeve të tërmetit dhe të gjitha shërbimet u ofruan në zyrën Tirana 2.

Numri i institucioneve dhe shërbimeve të ofruara në këto qendra të ADISA-s gjithashtu u rrit. Duke filluar nga Janari 2020 deri në Qershor 2020, këto qendra ofruan shërbime për qytetarët për të paktën 472 shërbime të ndryshme publike nga ISSH, DPGJC, FSDKSH, ASHK, QKB, DPT, etj. Nga shtatori 2020, në qendrat e saj ADISA ofron 50 shërbime publike online të institucioneve qendrore dhe 70 shërbime publike të institucioneve të pushtetit lokal.

Këto qendra kanë mundësuar përmirësimin e aksesit të qytetarëve dhe bizneseve në ofrimin e shërbimeve publike duke përmirësuar kulturën e shërbimit ndaj klientit dhe standardet e ofrimit të shërbimit. Këto qendra kanë për qëllim reduktimin e kohës së marrjes së shërbimit si edhe reduktimin e korrupsionit. Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka ofruar mundësi të shumta bizneseve dhe qytetarëve për të aplikuar në marrjen e shërbimeve publike online, përmes portalit e-Albania.

Hapa të konsiderueshëm janë bërë për të përmirësuar aksesin dhe disponueshmërinë e informacionit për qytetarët në shërbimet publike. Kjo përmirëson parashikueshmërinë në të gjithë procesin për të marrë një shërbim, duke lejuar rritjen e transparencës dhe uljen e kohës së qytetarëve për të marrë informacion mbi shërbimet publike. Pavarësisht ndryshimeve të fundit të parashikuara në Urdhrin e Kryeministrit, të cilat kërkojnë që procesi i aplikimit për disa shërbime publike duhet të bëhet online duke filluar nga Janari 2020, roli i ADISA-s është sërish i domosdoshëm në ndihmesën që i ofrojnë aplikuesve që vizitojnë qendrat.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka ofruar mundësi të shumta bizneseve dhe qytetarëve për të aplikuar në marrjen e shërbimeve publike online, përmes portalit e-Albania. Të pakën 38 shërbime mund të merren vetëm me vulë digjitale. Duke filluar nga muaji Janar 2020, procesi i aplikimit për 472 shërbime ofrohet vetëm online dhe numri po vazhdon të rritet. Si rezultat i integritit të sistemeve “back-end” të institucioneve, disa nga dokumentet e lëshuara nga institucione të tjera publike mund të merren nga vetë punëdhënësi dhe jo nga aplikanti.

Shtirirja e ADISA-s në zona të reja si edhe ndihmesa në procesin e aplikimit online për një numër të madh shërbimesh mendohet se rrit aksesueshmërinë e shërbimeve, redukton kohën e ofrimit të shërbimeve, redukton numrin e dokumenteve që duhet të dorëzohen nga qytetari, redukton korrupsionin dhe rrit nivelin e kënaqësisë së aplikantëve.

ADISA ka ndërmarrë disa hapa duke standardizuar informacionin mbi shërbimet publike dhe duke e bërë këtë informacion të disponueshëm në platforma të shumëfishta, si digjitale dhe jo-digjitale, për të arritur të gjitha kategoritë e popullsisë. Këto platforma përfshijnë Portalin e-Albania dhe faqen e web-it të ADISA-s, një linjë të dedikuar 08000118 (Shërbimi i Qendrës së Thirrjeve), si edhe qendrat e ADISA-s me sportele të dedikuara për ofrimin e informacionit për këdo që i viziton. Kjo përmirëson parashikueshmërinë e të gjithë procesit të marrjes së shërbimit, duke rritur transparencën dhe reduktuar kohën e marrjes së informacionit mbi shërbimet publike.


Një sondazh vlerësimi bazë është kryer në gjysmën e parë të vitit 2016, duke prodhuar të dhëna bazë për disa tregues, me qëllim matjen e progresit drejt objektivave të projektit. Një sondazh tjetër i ndërmjetëm u zhvillua gjithashtu për matjen e progresit në krahasim me vlerësimin bazë dhe objektivat e projektit. Gjetjet nga ky sondazh i ndërmjetëm, i zhvilluar në fund të vitit 2018 dhe përfunduar në 2019 konfirmojnë që progres domethënës është bërë drejt arritjes së Objektivave Zhvillimore të Projektit.

Të dhënat nxjerrin që aksesueshmëria e shërbimeve brenda qëllimit të projektit është përmirësuar me 12 pikë përqindje në total krahasuar me vlerësimin bazë (2016), me rritje domethënëse për gratë (18 pikë përqindje), të varfrit (18 pikë %) dhe Romët (17 pikë përqindje). Kënaqësia e qytetarëve me shërbimet gjithashtu është përmirësuar me një shkallë të tillë. Në këto kushte, vlerësimi final krahason progresin e bërë nga vlerësimet e mëparshme si edhe objektivat finale të studimit për treguesit kryesorë.

1.2 Përmbledhja e gjetjeve të studimit

1.2.1 Aksesi në shërbimet publike

Rezultatet e studimit final tregojnë që rreth 59% e të anketuarve kanë kontaktuar të paktën 1 nga 16 institucionet që janë në fokus të këtij për të marrë një shërbim gjatë 12 muajve të fundit. Ky rezultat është deri diku i ulët në krahasim me vlerësimin e ndërmjetëm (61%).



Kur ndahen sipas “Indeksit të pasurisë”, rezultatet tregojnë një tendencë më të madhe të shtresës së pasur për të kontaktuar institucionet, ku 69% prej tyre kanë kontaktuar të paktën një. Në të njëjtën kohë vërehet një rënie e vogël në përqindjen e shtresës së ulët si edhe një ulje më e madhe në atë të mesme. Në popullsinë Rome vërehet një ulje e madhe e shkallës së kontaktimit me institucionet. Vetëm 44% e të anketuarve të komunitetit Rom janë shprehur se kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, pra 26 pikë përqindje më pak se në vlerësimin e ndërmjetëm.

Rezultatet tregojnë një rritje të konsiderueshme të kontaktit me institucionet dhe ofrimin e shërbimeve në zyrat e ADISA-s pasi 10% e qytetarëve që kanë kontaktuar të paktën një institucion kanë vizituar të paktën 1 herë zyrat e ADISA-s, pra 6 pikë përqindje rritje nga të dhënat e vlerësimit të ndërmjetëm.



Institucionet më të kontaktuar janë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC). Rreth 41% e të anketuarve deklarojnë se e kanë kontaktuar atë të paktën një herë në 12 muajt e fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTR) me 14%, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) me 13%, dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) me 11% të kampionit. Institucione të tjera tregojnë një shpeshësi të kontaktimeve që është më e ulët se 10%. Qytetarët i kanë kontaktuar institucionet përmes metodës ballë për ballë (mbi 90% për pothuajse çdo institucion). Ndërkohë, mënyra të tjera të kontaktimit (përmes telefonit, ndërmjetësuesve, online) janë përdorur shumë pak, edhe pse vërehet rritje e përdorimit të internetit dhe teknologjive të tjera.


1.2.2 Treguesit kryesore të projektit

Bazuar në Kornizën e Rezultateve dhe Monitorimit të Projektit, Treguesi i dytë i Objektivave të Projektit përbëhet nga katër tregues specifik që lidhen me aksesueshmërinë e shërbimeve nga grupet në nevojë dhe të varfëra. Rezultatet e Vlerësimit final tregojnë një rritje të gjithë këtyre treguesve, duke treguar progres të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve publike për këto grupe.

Aksesueshmëria në shërbime për grupet në nevojë dhe të varfëra: Përqindja e të varfërve që janë shprehur se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte e “lehtë” ose “shumë e lehtë”. Treguesi llogaritet si përqindje e të intervistuarve të kategorizuar si të “varfër” (40% të kategorizuar nga Indeksi i Pasurisë), që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe kanë vlerësuar procesin e marrjes së shërbimit si “të lehtë” ose “shumë të lehtë”. Në vlerësimin final kjo shifër është 67%, ose 67% e të varfërve që shprehen se kanë marrë shërbime nga një institucion i kontaktuar në mënyrë “të lehtë” ose “shumë të lehtë”. Vlerësimi final tregon një rritje krahasuar me atë të ndërmjetëm (të matur në vitin 2018) (60%) rritje në krahasim me vlerësimin bazë (të matur në vitin 2016) (45%).


Duke pasur parasysh që objektivi final për këtë tregues është 70%, vlerësimi final është vetëm 3pp më i ulët nga objektivi (pika e referimit). Në këtë mënyrë, rezultatet tregojnë për një ndikim shumë pozitiv të projekti.

Lehtësia e aksesit të të varfërve në shërbimet publike




Përqindja e të anketuarve të komunitetit Rom që janë shprehur se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte e “lehtë” ose “shumë e lehtë”. Vlerësimi final tregon 63% e komunitetit Rom kanë shprehur se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte “e lehtë” ose “shumë e lehtë”. Vlerësimi final tregon një rritje krahasuar me atë të ndërmjetëm (61%) dhe gjithashtu një rritje në krahasim me vlerësimin bazë (47%). Duke pasur parasysh që objektivi final për këtë tregues është 72%, vlerësimi final është deri diku i ulët, pra 9 pikë përqindje. Në këtë mënyrë, rezultatet tregojnë aksesin i komuniteteve të marxhinalizuara në shërbimet publike ka vend për përmirësim.

Lehtësia e aksesit të komunitetit Rom në shërbimet publike



Përqindja e Femrave që janë shprehur se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte e “lehtë” ose “shumë e lehtë”. Treguesi llogaritet si përqindje e të intervistuarave femra që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe kanë vlerësuar procesin e marrjes së shërbimit si “të lehtë” ose “Shumë të lehtë”. Vlerësimi final tregon se 68% e femrave kanë shprehur se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte “e lehtë” ose “shumë e lehtë.” Vlerësimi final tregon një rritje krahasuar me atë të ndërmjetëm prej 62% dhe gjithashtu një rritje në krahasim me vlerësimin bazë (46%). Kjo tendencë tregon një progres të qëndrueshëm gjatë kësaj periudhë, ndërsa vlerësimi final tregon një rënie vetëm prej 3pp kundrejt treguesit final, prej 71%.


Lehtësia e aksesit të grave në shërbimet publike



Përqindja e meshkujve që janë shprehur se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte e “lehtë” ose “shumë e lehtë”. Treguesi llogaritet si përqindje e të intervistuarave femra që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe kanë vlerësuar procesin e marrjes së shërbimit si “të lehtë” ose “shumë të lehtë”. Vlerësimi final tregon se 63% e meshkujve kanë shprehur se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte "e lehtë" ose "shumë e lehtë". Vlerësimi final tregon një rritje krahasuar me atë të ndërmjetëm prej 60% dhe një rritje të konsiderueshme nga vlerësimi bazë prej 39%


Sikurse në rastin e treguesit të gjinisë femërore, *kjo tendencë tregon një progres të qëndrueshëm gjatë kësaj periudhë, ndërsa vlerësimi final tregon një rënie vetëm prej 1 pikë përqindje kundrejt treguesit final, prej 64%.*

Lehtësia e aksesit të meshkujve në shërbimet publike




Përqindja e të anketuarve në zonat urbane / rurale që shprehen se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte “e lehtë” ose “shumë e lehtë”. Treguesi llogaritet si përqindje e të anketuarve të kategorizuar sipas zonave: urbane e rurale që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe kanë vlerësuar procesin e marrjes së shërbimit si “të lehtë” ose “Shumë të lehtë”.

Lehtësia e aksesit për popullsinë rurale




Lehtësia e aksesit për popullsinë urbane



Vlerësimi i ndërmjetëm i këtij treguesi është 61% për zonat rurale dhe urbane, ose 61% e të anketuarve në zonat rurale dhe urbane shprehen se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuara ishte “e lehtë” ose “shumë e lehtë”. Vlerësimi final i treguesit të popullsisë urbane është 66%, që konsiston në 5 pikë përqindje më shumë nga vlerësimi i mëparshëm, ndërkohë që 64% e komunitetit rural konsiston në një rritje më të vogël, prej 3 pikë përqindje. Edhe në krahasim me objektivin final të dy treguesit paraqesin progres domethënës. Vlerësimi final për popullsisë urbane nuk e arrin objektivin final (67%) me vetëm 1 pikë përqindje, ndërsa vlerësimi i fundit për popullsinë rurale nuk e arrin objektivin final (68%) me 4 pikë përqindje.

Vlerësimi i kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet publike qëndron në thelb të qasjes së ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin. Në vlerësimin final, treguesi është në nivelin prej 68%, që do të thotë se nga të anketuarit që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, 68% e tyre janë shprehur se janë “deri diku të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me të gjitha institucionet e kontaktuara. Në krahasim me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, rezultatet e vlerësimit final kanë pësuar rritje me 3 pikë përqindje, gjë që tregon një progres të ngjashëm në krahasim me rritjen e aksesit (+ 4 pikë përqindje).

Kënaqësia me shërbimet publike, Popullata në total




Ndryshimet në shkallën e kënaqësisë në shtresat e ndryshme janë deri diku të papërfillshme (gjatë vlerësimit final), duke nënkuptuar një shkallë të qëndrueshme kënaqësie me shërbimet publike. Sipas gjinisë, shkalla e kënaqësisë me shërbimet gjatë vlerësimit final është më e lartë për femrat sesa meshkujt, respektivisht 70% dhe 66%. Kjo strukturë kënaqësie në të cilën gratë janë më të kënaqura se burrat me shërbimet publike konsiston në të gjitha fazat e vlerësimit.

1.2.3 Vlerësimi i shërbimeve publike

Vlerësimi reflekton atributet në nivel të përgjithshëm për pyetjet që kërkojnë informacion për disa dimensione të shërbimit (transparenca, llogaridhënia, drejtësia, shpejtësia e përpunimit, saktësia, orari i përshtatshëm i punës, lexueshmëria, vendndodhja e zyrave dhe sjellja e personelit dhe komunikimi). Dimensionet janë projektuar në një shkallë nga 0 në 100 ku 0 është “plotësisht negative” dhe 100 është “plotësisht pozitive” dhe standardet e kërkuara do të ishin për të marrë të paktën 85 pikë në shkallë.

Vlerësimi i dimensioneve të shërbimit publik




Rezultatet e vlerësimit final tregojnë se lexueshmëria e formave (formati dhe madhësia e shkrimit) është dimensionet e vlerësuar më shumë, me 84 nga 100 pikë, i ndjekur nga orari i përshtatshëm i punës me 82 pikë dhe sjellja dhe komunikimi i personelit me 80 pikë. Shpejtësia e përpunimit dhe drejtësia janë dimensionet me pikët më të ulëta (respektivisht 72 dhe 75 pikë) – ndonëse të dyja janë vlerësuar shumë. Në krahasim me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, pothuajse të gjitha dimensionet janë përmirësuar, përveç lexueshmërisë së formave që ka pësuar një rënie të lehtë nga 85 në 84 pikë si edhe vendndodhjes së zyrave nga 77 në 76 pikë.

Më tej, rezultatet tregojnë që rreth 14% e qytetarëve që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit kishin një arsye për tu ankuar lidhur me shërbimet e marra. Gjithsesi, vetëm 3% e të anketuarve që kanë kontaktuar të paktën një institucion, bënë një ankesë. Në krahasim me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, 14% e të anketuarve që kontaktuan të paktën një institucion kishin një arsye për tu ankuar, duke pësuar një rënie prej 1 pikë përqindje. Edhe në vlerësimin e ndërmjetëm, përqindja e qytetarëve që bënë një ankesë është shumë e ulët krahasuar me ata që kishin një arsye për tu ankuar, veçanërisht 5%.

1.2.4 Përvoja dhe perceptimi i korrupsionit

Ndonëse është bërë progres në aksesin dhe kënaqësinë me shërbimet publike, sjellja korruptive vazhdon të ekzistojë në institucionet publike. Të pyetur rreth përvojës mbi korrupsionin gjatë kontaktit me institucionin / institucionet, në rreth 9% të rasteve të anketuarit deklaruan ose ishte nënkuptuar ose kërkohet një ryshfet gjatë kontaktit, shifër që pësoi një rritje të lehtë nga vlerësimi fillestar dhe ai bazë. Gjithsesi, kjo sjellje korruptive lidhet më së shumti me disa situata problematike.



Institucionet të cilave ne ju referohemi janë kryesisht ASHK dhe DPSHTR. Qytetarët që kontaktuan ASHK, në 29% të rasteve deklaruan se një ryshfet ishte i kërkuar ose nënkuptuar. DPSHTR pason me 13% të rasteve ku qytetarët vërejnë që ryshfeti ishte kërkuar ose nënkuptuar. Institucione të tjera të përfshira në vlerësim kanë një nivel më të ulët se 13%, teksa vërehet që DPGJC dhe QKB kanë një nivel prej 2%. Sipas të anketuarve, qëllimi kryesor për ryshfet ishte “për të përshpejtuar procesin”. Krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, DPSHTRr, ASHK, FSDKSH, dhe SHKP tregojnë një rritje të nivelit të korrupsionit; rritje e cila është më domethënëse për ASHK dhe FSDKSH, e moderuar për SHKP, dhe minimale për DPSHTRr. Gjithsesi, analiza e mëtejshme lidhur me FSDKSH tregon që të anketuarit deklaruan më së shumti që një ryshfet ishte i nënkuptuar (13 nga 16 raste) më shumë se sa i kërkuar (3 nga 16 raste). Këto raste ndodhen në Tiranë (14 nga 16 raste), duke e bërë këtë një fenomen të izoluar.

Renditja finale e institucioneve lidhur me nivelin e korrupsionit të perceptuar nga qytetarët tregon një perceptim të lartë të sjelljeve korruptive në ASHK, DPT, dhe DPSHTRr. Në përgjithësi, ata që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, por nuk kanë pasur eksperiencë me korrupsionin, e rendisin atë në nivelin e 46 nga 100 pikë, ndërsa ata të cilët kanë kontaktuar një institucion publik dhe kanë pasur eksperiencë me korrupsionin japin një renditje më të lartë për krimin, 59 nga 100. Nga ana tjetër, ata të cilët nuk kanë kontaktuar asnjë institucion e rendisin atë me 52 nga 100 pikë. Në këtë rast, vërehet se mungesa përvojës personale me korrupsionin / ryshfetin çon vetëm në një rënie të moderuar të vlerësimit të korrupsionit. Perceptimi i përgjithshëm i “ryshfetit”, të krijuar përmes kanaleve të shumta të komunikimit si p.sh. media, miqtë dhe familja ose kolegët e punës, duket se ka një ndikim negativ domethënës në vlerësimin e korrupsionit, madje edhe qytetarët që kanë kontaktuar institucionet pro nuk kanë pasur përvojë vetjake me korrupsionin.


1.2.5 Shërbimet elektronike & kanalet e preferuara të komunikimit

Rreth 66% e të anketuarve shprehen se e dinë se çfarë është një shërbim elektronik i ofruar nga një entitet publik ose privat që rezulton në një rritje të shpejtë nga vlerësimi i ndërmjetëm (22%) dhe ai bazë (17%). Në mënyrë të qëndrueshme me nivelin e njohurive, ekziston një rritje e shpejtë në aksesin ndaj shërbimeve elektronike (publike dhe private). Rreth 16% e totalit të të anketuarve aksesuan shërbimet elektronike të paktën një herë, rreth 11 pikë përqindje më shumë se në vlerësimin e ndërmjetëm (12% e të anketuarve kanë aksesuar vetëm një shërbim publik, ndërsa 3% i kanë aksesuar të dyja dhe vetëm 1% kanë aksesuar vetëm shërbime elektronike private). Kjo përqindje është më e ulët ndërmjet të varfërve, të moshuarve dhe grupeve të popullsisë më pak të arsimuara.

Duke marrë në konsideratë vetëm e-Albania, 38% e të gjithë të anketuarve (N=2001) kanë aksesuar të paktën një herë platformën e-Albania. Nëse përjashtojmë të anketuarit që e kanë përdorur e-Albania për të marrë leje për të dalë nga shtëpia ose përdorur makinën për të shkuar në punë etj. gjatë periudhës së mbylljes së shkaktuar nga pandemia Covid19 (Mars – Maj 2020), shifra bie në mënyrë të ndjeshme në 9.5% të popullatës totale (N=2001).² E thënë ndryshe, 16.1% e të anketuarve që kanë kontaktuar të paktën një institucion (N=1183) kanë vizituar të paktën një herë e-Albania.

Përdormi i e-Albania për të aksesuar shërbimet publike

(përjashtuar përdorimin e lejes për të dalë nga shtëpia, përdorur makinën për të shkuar në punë gjatë periudhës së mbylljes së shkaktuar nga COVID - 19)




Rezultatet tregojnë ndryshime të konsiderueshme në aksesin/ përdorimin e e-Albania midis grupeve të ndryshme të popullsisë, gjë që dëshmon se shtresa e ulët, moshat më të vjetra dhe personat më pak të edukuar kanë mundësi shumë më të pakta për të aksesuar shërbimet elektronike publike. Duke pasur parasysh këtë ndarje bazuar në kontaktimin e të paktën një institucioni nga të anketuarit dhe për të shmangur keqkuptimet si rezultat i ndryshimeve lidhur me mos-kontaktimin e institucionit, vetëm 7% e

² Kjo shifër llogaritet si pjesë e numrit total të të anketuarve që tregojnë shkallën në të cilën e-Albania ishte përdorur për shërbime të tjera, përjashtuar marrjen e lejes për të dalë nga shtëpia, përdorur makinën për të shkuar në punë gjatë mbylljes së shkaktuar nga COVID - 19 (gjatë periudhës Mars - Maj 2020). Analiza e përdorimit të e-Albania përshkruhet më pas si një përqindje e të anketuarve që kanë kontaktuar të paktën një institucion, për të pasur të njëjtën shkallë krahasimore me metodat e tjera të kontaktimit.

shtresës së ulët të popullsisë (që kanë aksesuar të paktën një institucion) e kanë bërë këtë duke përdorur e-Albania.

Teksa vërehet një rritje e vogël në aksesin e shtresës së mesme, shtresa më e pasur paraqet një ndryshim të madh në përdorimin e e-Albania (+18 pikë përqindje më shumë nga shtresa e ulët dhe +14 pikë përqindje më shumë nga shtresa e mesme). Këto ndryshime mund të vërehen edhe kur konsiderojmë moshën, arsimin dhe qytetin. Moshat më të vjetra, popullatat me edukim fillor nivel më të ulët arsimimi) dhe ato që banojnë në zonat rurale kanë më pak mundësi që të aksesojnë shërbimet publike përmes përdorimit të e-Albania.



Rezultatet e vlerësimit final tregojnë që vetëm 4% e kampionit total kanë pasur vështirësi për të marrë informacionin e nevojshëm lidhur me shërbimin publik, ndërsa 57% nuk kanë pasur vështirësi (38% nuk kanë pasur fare kontakt). Rezultatet tregojnë ndryshime të vogla në krahasim me ato të vlerësimit të ndërmjetëm, në të cilin 6% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë hasur vështirësi. Pavarësisht rritjes së aksesit të internetit dhe teknologjive të tjera, të anketuarit ende preferojnë të marrin informacion mbi shërbimet publike përmes kontaktit ballë për ballë (79%). Referuar rezultateve të vlerësimit të ndërmjetëm ekziston një rritje në shumicën e mënyrave / kanaleve të ndryshme të ofrimit të shërbimit, më së shumti përmes numrit telefonik (qendrës së thirrjeve) (nga 13% në 17%), ndërsa nga ana tjetër, një rënie e rasteve të kanaleve të shtypit (nga 6% në 3%).

1.2.6 Përmbledhje e gjetjeve cilësore

Gjetjet cilësore tregojnë që progresi i bërë në aksesueshmërinë e shërbimeve publike është shumë dimensional dhe lidhet me një qasje me në qendër qytetarin. Rezultatet kryesore të rritjes së aksesit ndaj shërbimeve publike janë: **(i) më shumë zgjedhje për qytetarët; (ii) më shumë informacion për procesin e aplikimit; (iii) institucione më të ndërlidhura**

Parimi kryesor i hapjes së shërbimeve publike është **rritja e numrit të zgjedhjeve** përmes dhënies së më shumë kontrolli të drejtpërdrejtë qytetarëve lidhur me si (mënyrën) dhe ku (vendin) ku do të marrin shërbimet. Shifrat tregojnë se qytetarët pranojnë që mund ti kontaktojnë institucionet publike në tre mënyra: (1) përmes kontaktimit të institucionit; (2) zyrave të ADISA-s – aty ku është e mundur; dhe (3) e-Albania-s.

Në ditët e sotme qytetarët janë më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, kanë më shumë akses në **informacionin lidhur me shërbimet publike**, dhe si pasojë kanë pritshmëri më të larta lidhur me nivelin e shërbimit. Nga ana tjetër, ata janë mësuar me institucionet e sektorit privat që ofrojnë shërbime të personalizuar si edhe përfitime të tjera. Në këtë mënyrë, ata nuk janë të përgatitur që të pranojnë faktin se institucionet e sektorit publik janë të paafta për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të tyre, duke shtuar në këtë mënyrë presionin për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve. Nga ana tjetër ekziston më shumë informacion përmes kanaleve të ndryshme rreth ofrimit të shërbimeve publike (p.sh. kërkimi drejtpërdrejt në internet, kartelat informative të ADISA-s, informacion lidhur me shërbimin e-Albania, etj.) dhe gjithashtu institucionet mund që të japin tani më shumë detaje.

Më tej, aksesimi më i lehtë udhëhiqet edhe nga një perceptim më i mirë i qeverisjes pasi qytetarët perceptojnë një **strukturë me të mirë të ofrimit të shërbimeve përmes ndërlidhjes midis institucioneve** si edhe një ofrim të përmirësuar të shërbimeve tek qytetari. Perceptohet një ndryshim në lehtësinë e aksesit midis qytetarëve që kanë një zyrë ADISA në vendbanimin e tyre dhe atyre që nuk kanë. Qytetarët e zonave ku është ngritur një zyrë ADISA kanë informacion mbi shërbimet publike, më shumë zgjedhje si edhe një qeveri më të lidhur.

Gjetjet tregojnë se progresi në kënaqësinë me shërbimet publike lidhet fillimisht me procesin më i lehtë i aksesimit të tyre. Ekzistojnë gjithashtu dy faktorë shtesë të vëzhguar gjatë grupeve të diskutimit që kontribuojnë në shkallën e kënaqësisë: **(i) ofrimi i shërbimeve të premtuara; (ii) shpejtësi e përmirësuar.**

Informacioni rreth shërbimeve (p.sh përshkrimi specifik i shërbimit, përdormi, koha e ofrimit, etj.) vendos pritshmëri paraprake rreth shërbimit. Nga ana tjetër, mungesa e informacionit (madje edhe një mungesë e qëllimit për kërkimin e të dhënave të sakta) pengon pritshmëritë, i drejton qytetarët gabimisht dhe krijon pakënaqësi. Por, qytetarët e informuar (edhe për grupet e marxhinalizuara) deklarojnë të kenë marrë shërbimin e premtuar.

Vërehet një përmirësim në perceptimin e përgjithshëm të procesit të ofrimit të shërbimeve, kryesisht atyre për marrjen e dokumenteve bazë (si p.sh. një certifikatë personale, e cila, sikurse shumë pjesëmarrës ishin në dijeni, kërkonte pak minuta për tu nxjerrë nga e-Albania), si edhe atyre më të ndërlidhura (si p.sh. aplikimi dhe marrja e kartës së identitetit). Gjithsesi ka disa shërbime specifike të lidhura me ASHK të cilat shumë shpesh çojnë në sjellje korruptive. Kjo sjellje (sikurse deklarohet nga pjesëmarrësit e grupit të

diskutimit) lidhet me përpjekjet e punonjësve të institucionit për të zgjatur kohën e dhënies së shërbimit – duke pritur ryshfet për të përshpejtuar procesin.

Diskutimet sugjeruan se shpejtësia e ofrimit të shërbimit lidhet më shumë me procesin e aplikimit se sa me marrjen e shërbimit. Në këtë drejtim, ajo lidhet me një nga komponentët e kënaqësisë: ofrimin e shërbimit të premtuar (veçanërisht të njohur më parë si koha e ofrimit) dhe një proces të përshpejtuar, të paktën për shërbimet kryesore.

Përsa i përket shërbimeve elektronike, gjetjet tregojnë se qytetarët po i aksesojnë gjithmonë e më shumë shërbimet përmes e-Albania: personalisht, të ndihmuar nga dikush tjetër ose përmes një entiteti publik ose privat. Pjesëmarrësit e grupeve me moshë më të re deklarojnë që përdorin e-Albania zakonisht si një mjet i shpejtë për marrjen e shërbimeve. Gjithsesi, edhe pse aplikimi mund të merret përmes e-Albania, ata deklaruan që për shumicën e aplikimeve të bëra ato duhet të kontaktonin institucionin në mënyrë të drejtpërdrejtë për të marrë shërbimin (përveç shërbimeve kryesore si certifikata personale).

Unë zakonisht kontrolloj pagesat e sigurimeve (në e-Albania), por së fundmi kam aplikuar për pensionin e pleqërisë së mamasë time. E kam bërë atë pjesërisht nga e-Albania, pjesërisht nga institucioni (duke nënkuptuar ISSH-në në këtë rast) ...



Femër, 34 vjeç, Korçë, zonë rurale

Edhe pse përdoruesit e “e-Albania” janë të kënaqur me aplikimin përmes portalit dhe nuk e kanë problem që të shkojnë në zyrat e institucionit që te marrin shërbimin, pjesëmarrësit e grupeve të diskutimit shfaqin pakënaqësi rreth politikës së fundit për ti kaluar të gjitha aplikimet për shërbime tek e-Albania. Grupmoshat më të vjetra nuk e konsiderojnë veten të aftë për të aksesuar portalin (nuk janë në gjendje të përdorin një telefon inteligjent ose internetin në mënyrë korrekte), një fakt i pranuar gjithashtu edhe nga grupmoshat më të reja.



Sikurse tha X, ne njohim njerëz që jetojnë në fshate të largëta që mezi përdorin telefonin e lëre pastaj e-Albania.



Femër, 48 vjeç, Tiranë, Zonë rurale



Nëse më duhet që ta përdor atë (duke ju referuar "e-Albania"-s), e bëj atë përmes djemve ose nuseve të mia ...



Mashkull, 60 vjeç, Shkodër, zonë rurale

Në rastin kur nuk janë në gjendje ti drejtohen vetë portalit "e-Albania", qytetarët ende shkojnë tek institucionet drejtpërsëdrejti. Ka raste si p.sh. në ASHK, ku një punonjës udhëzon qytetarin (kjo gjë vërehet në Korçë ku nuk ka një qendër ADISA). Ata shkojnë tek ADISA, e cila i ndihmon për të bërë aplikimin përmes e-Albania. Një tjetër "ofruer shërbimi" po rritet me shpejtësi, i cili ofron privatisht përfundimin e aplikimit përmes e-Albania, sikurse deklaruan pjesëmarrësit e grupit të diskutimit, si p.sh. zyrat e noterisë ose qendrat e internetit. Më në fund, kjo kategori e qytetarëve i drejtohen të afërmve të tyre më të rinj, të cilët e bëjnë aplikimin për ta.



...Për sa i përket e-Albania, unë jam një nga personat e lagjes time që përdor e-Albania për të gjithë miqtë dhe kushërinjtë ...



Mashkull, 27 vjeç, Tiranë, zonë urbane, komuniteti Rom



... Unë aplikova përmes e-Albania, por nuk funksionoi, kështu që shkova tek ADISA dhe pyeta se përse aplikimi nuk u realizua. Ata më treguan se si ta bëja aplikimin. Unë ri-aplikova përmes e-Albania me sukses.



Femër, 28 vjeç, Tiranë, zonë urbane



...Në e-Albania, unë hapa një llogari për mamanë time, pasi ajo donte një certificate personale ...



Femër, 30 vjeç, Tiranë, zonë urbane



... Kam bërë shumë aplikime përmes e-Albania tek ASHK këtë vit. E fillova procedurën tek ASHK; ata na orientuan ne, mundësisht bënë gjysmën e punës, gjysma tjetër u bë online. Por ne nuk dinim se si të aplikojmë online, jo sepse ne dimë ose s'dimë ta përdorim atë, por sepse aplikimi është i komplikuar, kështu që ai (duke nënkuptuar punonjës të ASHK) bëri aplikimin online për ne...



Femër, 30 vjeç., Korça, Urban

Një nga pjesëmarrësit e grupit të diskutimit ishte punonjës në një zyrë noterie që ka ofruar ndihmesë për aplikime përmes e-Albania.

Ajo përshkruan ndihmesën për të aksesuar “e-Albania” si thelbësor për të gjitha grupet, jo vetëm moshat e vjetra, ose qytetarët që nuk janë në gjendje të përdorin teknologjinë, si një mënyrë për të aplikuar për shërbimet (jo ato kryesore) është më i komplikuar dhe në më të shumtën e rasteve nuk mund të arrihet vetëm përmes e-Albania.

“

Zyra jonë është e re dhe reagimi që marrim nga qytetarët është shumë pozitiv, sepse unë mendoj se jo të gjithë njerëzit dinë se si të aplikojnë në “e-Albania”, sidomos institucione si ASHK, ku ju duhet të keni dokumentet si edhe informacion të saktë paraprak (lidhur me aplikimin). Zyra jonë lehtëson këtë shërbim sepse ne marrim përsipër të gjithë aplikimin, përpilimin e dokumenteve, dërgimin e tyre përmes postës etj, si edhe reduktimin e kontaktit me institucionin.

Femër, 23 vjeç., Tiranë, zonë urbane

”

“

Të moshuarit mund të kenë informacion mbi procesin, por nuk dinë të përdorin shërbimet elektronike. Të rinjtë dinë të përdorin shërbimet elektronike, por nuk njohin procesin. Pra, gjithmonë ekziston një problem.

Femër, 23 vjeç., Tiranë, zonë urbane

”

3.2 Aksesimi i shërbimeve publike

Ndikimi i të mirave publike dhe shërbimeve thelbësore në jetët e qytetarëve varet në mënyrë domethënëse në shkallën në të cilën mund të merren dhe përdoren shërbimet.


Akresi ndaj shërbimeve të disponueshëm mund të konsiderohet një kriter performance për qeveritë, duke reflektuar kapacitetin e tyre për të njohur diversitetin dhe natyrën, krijuar dhe adaptuar kanalet e ofrimit dhe komunikimit dhe garantuar barazinë dhe drejtësinë në shpërndarje.

Pengesat për të aksesuar shërbimet publike janë multidimensionale duke përfshirë distancën, pajisjet e pa përshtatshme, informacionin e pamjaftueshëm, disa kanale të ofrimit të shërbimit, barrën e lartë administrative dhe përballimin e shërbimeve. Këto pengesa mund të ulin ndërgjegjësimin ndaj kriterëve ose ekzistencën e shërbimeve ose të shkurajojë marrësit e mundshëm, dhe që ndikojnë në aksesueshmërinë e shërbimeve publike. Për të vlerësuar këtë situatë, “Anketa kombëtare e familjeve” u kërkon të anketuarve që të vlerësojnë në një shkallë nga 1 në 5, ose “shumë e lehtë” deri në “shumë e vështirë” shkallën e lehtësisë së përgjithshme në shërbimet publike, dhe bazuar në këto përgjigje të marra, të vlerësojnë më tej “aksesin në shërbimet publike”.

3.2.1 Aksesimi i shërbimeve publike sipas indeksit të pasurisë

Treguesi i parë vlerëson aksesin e të varfërve në shërbime: *Përqindja e të varfërve që deklaruan se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte “e lehtë” ose “shumë e lehtë”*. Figura 34 tregon rezultatet për treguesin e “lehtësisë së aksesit në shërbimet publike sipas indeksit të pasurisë”. Specifikisht, treguesi llogaritet si një përqindje e të anketuarve të kategorizuar si “të varfër” (40% më i varfër i kategorizuar nga indeksi i pasurisë) të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe kanë vlerësuar procesin e marrjes së shërbimit për të gjitha institucionet e kontaktuar si “i lehtë” ose “shumë i lehtë”.

Figura 34: Indikator i aksesimit të shërbimeve publike sipas indeksit të pasurisë



Rezultati i indeksit të vlerësimit bazë të matur në 2016, është 45%, ose 45% e të varfërve deklarojnë se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuara është "e lehtë" ose "shumë e lehtë." Në krahasim me vlerësimin bazë, ai i ndërmjetëm tregon përmirësim në lehtësinë e aksesit në shërbimet publike pasi 60% e të varfërve deklaruan se marrja e shërbimit nga institucioni i kontaktuar është "e lehtë" ose "shumë e lehtë", duke shënuar një rritje prej 15 pikë përqindje nga vlerësimi bazë. Përmirësimi vazhdon në vlerësimin final me 67% e të anketuarve që deklaruan sa më sipër, me rreth 7 pikë përqindje më shumë. Duke marrë parasysh që objektivi final për këtë tregues është 70%, rezultati i vlerësimit final bie vetëm 3 pikë përqindje më pak se objektivi. Pra, rezultati tregon për një ndikim shumë pozitiv të projektit.

Në përgjithësi, lehtësia e treguesit të aksesit në shërbimet publike është 65%, ose 65% e të anketuarve që kanë kontaktuar të paktën një institucion e konsiderojnë procesin e marrjes së shërbimit si "të lehtë ose "shumë të lehtë", që konsiston në një rritje prej 4 pikë përqindje nga treguesi i vlerësimit bazë. Më tej, ndryshimet midis shtresave të ndryshme të popullsisë janë të vogla.


3.2.2 Aksesimi i shërbimeve publike sipas gjinisë, zonës dhe moshës

Duke analizuar më tej treguesin e lehtësisë së aksesit ndaj shërbimeve publike ndërmjet grupeve të ndryshme, rezultatet lidhur me grupet në nevojë janë reflektuar në krahasim me ato të vlerësimit bazë si edhe kategori të tjera relevante.

Ndarja sipas moshës e vendos theksin tek aksesin në shërbime të femrave: Përqindja e femrave që deklaruan se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktura ishte "e lehtë ose "shumë e lehtë". Treguesi llogaritet si një përqindje e të anketuarave femra të cilat kontaktuan të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe vlerësuan procesin e marrjes së shërbimit për të gjitha institucionet si "të lehtë ose "shumë të lehtë".

Rezultat i treguesit të vlerësimit të ndërmjetëm është 62%, ose 62% e të anketuarave femra deklaruan se marrja e shërbimeve nga një institucion i kontaktuar ishte "i lehtë ose "shumë i lehtë". Vlerësimi final tregon përmirësim në krahasim me atë të ndërmjetëm në aksesin e shërbimeve publike nga femrat, pasi 68% e tyre kanë deklaruar që marrja e shërbimit nga institucioni i kontaktuar ishte "i lehtë ose "shumë i lehtë", duke shënuar një rritje prej 6 pikë përqindje nga vlerësimi i ndërmjetëm. Kjo tregon se gjatë kësaj periudhe ka pasur përmirësime të qëndrueshme. Vlerësimi final është 3 pikë përqindje më poshtë se objektivi i caktuar i këtij treguesi që është 71%.

Figura 35: Indikatori i aksesimit të shërbimeve publike sipas gjinisë



Më tej merret në konsideratë lehtësia e aksesit për meshkujt: përqindja e meshkujve që deklaruan se marrja e shërbimeve nga një institucion i kontaktuar ishte "i lehtë ose "shumë i lehtë". Treguesi llogaritet si një përqindje e përqindje e të anketuarve meshkuj të cilat kontaktuan të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe vlerësuan procesin e marrjes së shërbimit për të gjitha institucionet si "të lehtë ose "shumë të lehtë".

Vlerësimi final është 63%, që do të thotë 63% e meshkujve që deklaruan se marrja e shërbimeve nga një institucion i kontaktuar ishte "i lehtë ose "shumë i lehtë". Ky vlerësim tregon një rritje krahasuar me rezultatet e vlerësit të ndërmjetëm prej 60% si edhe një rritje të konsiderueshme në krahasim me vlerësimin bazë prej 39%. Sikurse në treguesin popullatës femër, vërehet përmirësim i qëndrueshëm gjatë kësaj periudhe, ndërsa vlerësimi final është vetëm 1 pikë përqindje më pak se objektivi prej 64% i këtij treguesi.

Indeksi rajonal llogaritet si një përqindje e të anketuarve të kategorizuar si urban ose rural, të cilat kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe kanë vlerësuar procesin e marrjes së shërbimit për të gjitha institucionet si "të lehtë ose "shumë të lehtë".

Figura 36 tregon rezultatet lidhur me këtë tregues. Rezultati i këtij treguesi në vlerësimin e ndërmjetëm është 61% për zonat urbane dhe rurale, ose 61% e të anketuarve në zonat urbane dhe rurale kanë deklaruar se marrja e shërbimeve nga institucionet e kontaktuar ishte "e lehtë" ose "shumë e lehtë". Rezultati final i treguesit të popullsisë urbane është 66%, që përbën një rritje prej 5 pikë përqindje nga vlerësimi i mëparshëm, ndërsa 64% e popullsisë rurale kishte një rritje më të vogël prej 3 pikë përqindje. Kur merret parasysh objektivi final, të dy treguesit shfaqin përmirësime domethënëse. Vlerësimi final i popullsisë urbane nuk e arrin objektivin prej 67% vetëm me 1 pikë përqindje, ndërkohë që komuniteti rural nuk e arrin atë për vetëm 4 pikë përqindje.

Figura 36: Indikatorit të aksesimit të shërbimeve publike sipas zonës





Figura 37 tregon rezultatet e indikatorit për 2 grupmosha: nën 55 vjeç dhe mbi 55 vjeç duke u fokusuar në ata persona të moshuar më në nevojë. Rezultati final për të dyja grupet është 65%, duke shënuar një rritje prej 8 pikë përqindje për grupmoshën më të moshuar në krahasim me vlerësimin e ndërmjetëm dhe vetëm 3 pikë përqindje për atë nën 55 vjeç. Të dhënat sugjerojnë përmirësime të mëdha lidhur me aksesin në shërbimet publike të popullsisë së moshuar.


Figura 37: Indikatorit të aksesimit të shërbimeve publike sipas moshës



3.2.3 Aksesimi i shërbimeve publike: Popullsia Rome

Popullsia Rome është ende një grup i marxhinalizuar në lidhje edhe me aksesimin e shërbimeve publike. Indikatori llogaritet si përqindja e të anketuarve të komunitetit Rom, të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit dhe kanë vlerësuar procesin e marrjes së shërbimit, për të gjitha institucionet e kontaktuara, si "e lehtë" ose "shumë e lehtë".

Figura 38: Indikatori i aksesimit të shërbimeve publike: Popullsia Rome sipas gjinisë



Rezultatet e vlerësimit final tregojnë se 63% e familjeve Rome deklaruan se marrja e shërbimeve nga institucioni i kontaktuar është "e lehtë" ose "shumë e lehtë" që shënon vetëm 2 pikë përqindje nga vlerësimi i ndërmjetëm. Duke marrë në konsideratë objektivin final prej 72%, shohim që rezultati final është shumë i ulët, rreth 9 pikë përqindje. Rezultatet nënkuptojnë që ekziston ende një mënyrë në bërjen e shërbimeve publike më të aksesueshme për grupet e tilla të marxhinalizuara.

Në përgjithësi, meshkujt Romë i konsiderojnë më të aksesueshme shërbimet publike se gratë Rome, 61% kundrejt 64%, me ndryshime të vogla gjinore. Gjithsesi, në këtë vlerësim ne nuk marrim parasysh ndryshimet ndërmjet grupmoshave dhe zonave. Këto kategori kanë numër shumë të vogël të anketuarish për të prodhuar rezultate domethënëse (kryesisht popullsi rurale që ka kontaktuar të paktën një institucion janë vetëm 9 të anketuar dhe vetëm 10 mbi moshën 55 vjeçare).

3.2.4 Aksesimi i shërbimeve publike: rezultate shtesë

Një nga komponentët më thelbësorë të ofrimit të shërbimeve publike lidhet me rolin e ADISA-s e cila u krijua për të menaxhuar ofrimin e centralizuar të shërbimeve publike për qytetarët. Duke marrë parasysh gjithashtu edhe zhvillimet e fundit, ADISA vazhdon të ketë një pjesë thelbësore në ofrimin e shërbimeve publike në qarqet ku qendrat e saj operojnë. Nga totali i të anketuarve që kanë kontaktuar të paktën një institucion, rreth 8% i kanë kontaktuar ato vetëm përmes ADISA-s. Duke krahasuar indikatorin e aksesimit të institucionit vetëm përmes ADISA-s, rezultatet tregojnë që ky grup e konsideron atë më të lehtë (4 pikë përqindje më të lartë) se popullsia e përgjithshme.

Figura 39: Krahasimi i aksesimit: aksesimi përmes ADISA





Figura 40 tregon aksesimin e shërbimeve publike të shpërndarë sipas qarqeve për të tre vlerësimet. Rezultatet e vlerësimit final tregojnë që Shkodra është qarku me nivelin më të lartë të aksesimit e ndjekur nga Gjirokastra dhe Berati. Nga këta 3 qarqe Shkodra dhe Gjirokastra kanë qendra ADISA. Qytetarët e Shkodrës kanë përjetuar rritje të madhe të aksesimit sikurse paraqitet edhe në rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm dhe atij final. Nga ana tjetër, qytetarët e Gjirokastrës kanë përjetuar rritje gjatë vlerësimit të ndërmjetëm dhe stacion gjatë atij final. Qarqe të tjera që kanë një prani të ADISA si p.sh. Fieri ose Durrësi kanë përmirësim domethënës gjatë të tre vlerësimeve. Nga ana tjetër, edhe pse ka një rritje domethënëse sipas rezultateve të vlerësimit bazë dhe atij të ndërmjetëm, vlerësimi final paraqet një stanjacion, ku shënohet vlera më e ulët e indikatorit (qarku Kukës renditet i fundit).

Figura 40: Aksesimi i shërbimeve publike sipas qarkut




Teksa vlerësojmë aksesimin e shërbimeve publike nga qytetarët, ne konsiderojmë mundësinë shtesë të vlerësimit të lehtësisë së aksesimit: *përqindja e njerëzve që KANË PASUR nevojë të aksesojnë shërbime të synuara, por NUK kanë mundur t'i aksesojnë për shkak të së paku një prej arsyeve të mëposhtme:*

- Mungesa e informacionit
- Distanca deri në pikën e shërbimit
- Kostoja e marrjes së shërbimit (kostoja totale e të gjitha fazave)
- Koha e gjatë që nevojitet për t'u përgatitur, aplikuar dhe përfituar shërbimin
- Nevoja për të dhënë rryshfet, për të përfituar shërbimin

Indikatori shtesë llogaritet si përqindja e të anketuarve të cilët për të paktën një institucion, kanë pasur nevojë ta kontaktojnë për të marrë një shërbim, por nuk e kanë kontaktuar, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve. Figure 41 tregon rezultatet për indikatorin. Rezultatet finale tregojnë se vetëm 6% e të anketuarve kanë pasur nevojë ta kontaktojnë për të marrë një shërbim, por nuk e kanë kontaktuar atë. Në vlerësimin final ka një përmirësim jo domethënës në krahasim me atë të ndërmjetëm me vetëm 1 pikë përqindje, ndërkohë që vlen të theksohet se indikatorin ishte edhe më parë në nivele të ulëta.


Figure 41: Shërbimet e nevojshme që nuk janë aksesuar (nuk janë kontaktuar)



Të pyetur se përse ata nuk kanë kontaktuar institucionet e nevojshme dhe duke lejuar përgjigje të shumëfishta, deri tani, arsyeja më e përmendur është se një anëtar i familjes ka kontaktuar institucionet në vend të të anketuarit.

Të tjerë përmendin arsye që lidhen me tërheqjen e qytetarit nga aksesimi i shërbimeve. Marrja e një shërbimi mund të jetë një proces shumë i ndërlikuar (I cili lidhet me kategorinë e dytë që është mungesa e kohës).

Figura 42: Përse nuk e keni kontaktuar institucionin për shërbimin e nevojshëm? (lejohen shumë përgjigje)



3.2.5 Aksesimi i shërbimeve publike: gjetjet cilësore

Gjetjet cilësore tregojnë që progresi në aksesimin e shërbimeve publike është shumë dimensional, por i lidhur me një qasje me në qendër qytetarin. Rezultatet kryesore e rritjes së aksesimit të shërbimeve publike janë: (i) më shumë zgjedhje për qytetarët; (ii) më shumë informacion rreth procesit të aplikimit; (iii) institucione më të ndërlidhura

Parimi kryesor i shërbimeve publike të aksesueshme për qytetarin është **rritja e numrit të zgjedhjeve** përmes dhënies së më shumë kontrolli të drejtpërdrejtë qytetarëve lidhur me si (mënyrën) dhe ku (vendin) ku do të marrin shërbimet. Shifrat tregojnë se qytetarët pranojnë që mund ti kontaktojnë institucionet publike në tre mënyra: (1) përmes kontaktimit të institucionit drejtpërsëdrejti; (2) zyrave të ADISA-s – aty ku është e mundur; dhe (3) e-Albania-s.



Në përgjithësi në ditët e sotme procedurat administrative janë thjeshtuar. Me kalimin e kohës ata po përpiqen ti thjeshtojnë ato edhe me shumë për shkak të shërbimeve online duke e përmirësuar sistemin duke e bërë më të lehtë dhe të aksesueshëm për të gjithë qytetarët. Administrata publike shqiptare qëndron pak më mbrapa dhe ka ende shumë gjëra për të përmirësuar. E vetmja gjë që me shkoi në mendje për të marrë një shërbim ose informacion të përgjithshëm janë qendrat e ADISA-s të hapura për këtë qëllim. Në një institucion të vetëm, ju mund të merrni informacion dhe të drejtoheni. Ekzistojnë qendrat me një ndalesë që priten të shpërndahen në të gjitha njësitë administrative. Ende, është një shërbim që nuk ka filluar ende të zbatohet ën Shqipëri, por që mendoj se është një zgjidhje më e mirë se sa në një zyrë të vetme ku qytetari vjen, informohet dhe aplikon. Më pas, nga specialistët merret dhe shpërndahet tek ato institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e kësaj çështje. Në këtë pikëpamje administrata shqiptare ka punë për të bërë. Shërbimi i informacionit për qytetarët është i disponueshëm, të paktën ai që ofrohet në njësinë tonë. Të gjithë qytetarët që vijnë mund të marrin informacion nga punonjësit që janë aty, por mbetet pjesa tjetër që ata marrin informacionin, por janë të detyruar të shkojnë aty ku punonjësi i drejton ata. Kjo pjesë mbetet.

Femër, 26 vjeç, Tiranë, zonë rurale



... Unë kam aplikuar për rinovimin e pasaportës përmes e-Albania. Është një zgjidhje e përkryer për ta përdorur për shërbimet publike.

Femër, 25 vjeç, Shkodër, zonë urbane



Unë kam pasur informacion për ADISA-n përpara hapjes së saj ...Aty ju mund të shkoni tek 3-4 institucione publike. ADISA i përfshin të gjitha ato.

Mashkull, 60 vjeç, Shkodër, zonë rurale



Gjithsesi, zgjidhja ka vlerë të limituar nëse njerëzit nuk kanë aftësinë për ta përdorur atë ose shërbimet e nevojshme nuk kanë standard të lartë.

Qytetarët e sotëm janë më të ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre, kanë më shumë akses në **informacionin mbi shërbimet publike** dhe rrjedhimisht kanë pritshmëri të larta mbi nivelin e shërbimit. Nga njëra anë për shkak se ato janë njohur me organizatat private të shoqërisë civile që ofrojnë nivele të larta të përshtatjes dhe përfitimeve të tjera, ato nuk janë të përgatitura për të pranuar që organizatat e sektorit publik janë të paafta për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të tyre. Nga ana tjetër, ka më shumë informacion në dispozicion përmes kanaleve të ndryshme rreth ofrimit të shërbimeve publike (p.sh kërkimi drejtpërsëdrejti në internet, kartelat informative të ADISA; informacion mbi shërbimin në e-Albania, etj.), dhe gjithashtu institucionet mund të ofrojnë drejtpërsëdrejti më shumë informacion.



(Si e kërkonti informacionin) Unë fillimisht kërkoj në internet ose në faqen e webit të institucionit që është (ose mund të jetë) përgjegjës për shërbimin që dua. Unë përdor fjalë kyçe dhe zakonisht funksionon.

Femër, 27 vjeç, Shkodër, zonë rurale



Për informacion ..., është lehtësisht i aksesueshëm përmes e-Albania.

Femër, 37 vjeç., Korçë, zonë rurale



Unë gjithashtu doja të ndaja pak eksperiencë. Për kartën e identitetit, për të cilën aplikova personalisht, unë u përballa direkt me institucionin. Hapi i parë që ndërmora ishte që të shkoja tek zyra e gjendjes civile të lagjes. Pyeta aty se çfarë mund të bëja lidhur me aplikimin. Ata mi shpjeguan të gjitha.

Mashkull, 35 vjeç., Tiranë, zonë urbane, popullsia Rome



Aksesimi ka të bëjë me një nivel më të lartë të perceptimit se institucionet janë më të ndërlidhura. Kjo nënkupton integrimin ose bashkimin / koordinimin e shumë agjencive për të ofruar shërbime që plotësojnë nevojat e klientit dhe jo nga udhëzimet e njësisë vertikale të agjencive. Nuk ka të bëjë me ristrukturimin e plotë të qeverisë, por ka të bëjë me adoptimin e një qasje të integruar për informacionin dhe hapat e proceseve në zyrat mbështetëse dhe sportelet pritëse që ndihmojnë në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve. Qytetarët perceptojnë një strukturë të përgjithshme më të mirë të ofrimit të shërbimeve publike përmes ndërlidhjes më të mirë ndërmjet institucioneve dhe ofrimit më të mirë të shërbimeve.

Për me tepër, perceptohet një ndryshim i aksesimit ndërmjet qytetarëve që kanë një zyrë ADISA në vendbanimin e tyre dhe ata që nuk e kanë (sikurse tregohen fillimisht në figurën 40). Qytetarët nga Korça (urban) janë më pak të aftë të marrin informacion mbi shërbimet publike, kanë më pak zgjedhje dhe institucione më pak të lidhura.



Jo çdo institucion ka një zyrë informacioni. (kur u pyetën rreth vështirësive në marrjen e informacionit). Ose ka një rojë sigurie tek dera e zyrës së informacionit i cili ju jep një informacion të shkurtër: hajde sot, hajde nesër, etj.



Mashkull, 38 vjeç, Korçë, Zonë urbane



Ka gjithashtu mungesë të njohjes së kompetencave të institucioneve, ato nuk njohin kompetencat ... stafi nuk ka njohuritë (ose dëshirën) për të dhënë një përgjigje. Stafi zakonisht preferon që t'ja presi shkurt, duket sikur ato nuk duan t'ju shërbejnë fare. Sipas ligjit, nga ana tjetër, ata duhet të përgjigjen. Nëse personi nuk është i kënaqur me një përgjigje zyrtare (duke pasur parasysh që nuk është e plotë apo e saktë), ai duhet të gjejë dikë tjetër në institucion sipas hierarkisë.



Femër, 48 vjeç., Korçë, zonë urbane



Ka diçka që mungon në të gjitha institucionet, nëse p.sh unë dua të hap një numër për regjistrimin e biznesit (NIPT) dhe të regjistroj një biznes të ri, çfarëdo pyetje që të kem ose shërbimi që më duhet, kjo gjë duhet të bëhet menjëherë, kështu që unë nuk duhet të shkoj në disa institucione dhe në një institucion disa herë.



Mashkull, 38 vjeç., Korçë, zonë urbane

3.3 Kënaqësia me shërbimet publike

Matja e kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet publike është thelbi i qasjes ndaj ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarin dhe është një komponent i rëndësishëm i strategjive të performancës organizative për përmirësim të vazhdueshëm. Të dhënat e perceptimit zakonisht përdoren për të vlerësuar përvojat e qytetarëve me agjencitë publike dhe për të marrë pikëpamjet e tyre në të gjithë procesin e shpërndarjes së shërbimeve. Një informacion i tillë mund të ndihmojë drejtuesit publikë të identifikojnë kënaqësinë e përgjithshme, si dhe të monitorojnë ndikimin e reformave në përdoruesit përfundimtarë. Për më tepër, kënaqësia e qytetarëve mund të jetë një tregues i rëndësishëm i performancës së përgjithshme të shërbimit publik.


Në përpjekje për të përmirësuar përgjegjshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve publike, Anketa e Kombëtare e Familjeve, projektton një sërë rezultatesh që matin kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet publike në përgjithësi për kampionin e përgjithshëm dhe për nënkategoritë e ndryshme të kampionit. Me rëndësi më të madhe është edhe përparimi i ofrimit të shërbimeve publike. Prandaj, analiza e nivelit të kënaqësisë me shërbimet publike ofron një krahasim të rezultateve finale me ato të ndërmjetme dhe fillestare, duke ofruar një bazë të qartë për vlerësimin e progresit.

Për të matur nivelin e kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet publike, përdoret një indikator që vlerëson përvojën që qytetarët kanë pasur me shërbimet publike gjatë 12 muajve të fundit. Anketa ka një pyetje të shkallës së Likert-it lidhur me nivelin e kënaqësisë nga shërbimet publike, ku në një shkallë nga 1 deri në 5, të anketuarit deklarojnë të jenë të pakënaqur ose të kënaqur me kontaktet e tyre me institucionet (nëse ka). Treguesi llogaritet si *përqindje e të anketuarve, të cilët për të gjitha institucionet që ata kanë kontaktuar për të marrë një shërbim publik gjatë 12 muajve të fundit, deklarojnë se janë “deri diku të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimin e marrë.*

3.3.1 Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas indeksit të pasurisë

Figura 43 tregon rezultatet e të tre studimeve lidhur me treguesit e “kënaqësisë së shërbimeve publike” të ndara sipas indeksit të pasurisë. Në vlerësimin final treguesi është në nivelin 68%, që do të thotë se nga të gjithë të anketuarit që kishin kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundi), 68% e tyre deklaruan se ishin “deri diku të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me të gjitha institucionet e kontaktuara. Ky indikator në vlerësimin final është rritur me 3 pikë përqindje në krahasim me vlerësimin e ndërmjetëm, duke treguar gjithashtu progres kur krahasohet me rritjen e aksesimit (+4 pikë përqindje). Ndryshimet në nivelet e kënaqësisë midis shtresave të ndryshme janë deri diku të pakonsiderueshme duke nënkuptuar një strukturë të qëndrueshme të kënaqësisë me shërbimet publike.


Figura 43: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas indeksit të pasurisë



3.3.2 Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas gjinisë, zonës së banimit dhe moshës


Kur shihen diferencat sipas gjinisë, kënaqësia me shërbimet publike është në një nivel më të lartë për të anketuarat femra sesa për të meshkujt, 70% dhe 66% respektivisht në vlerësimin final. Prandaj, 70% e të intervistuarve femra, të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, janë "disi të kënaqura" ose "shumë të kënaqura" me të gjitha institucionet e kontaktuara. Kjo strukturë e nivelit të kënaqësisë ku femrat janë më të kënaqura se meshkujt me shërbimet publike vërehet gjatë të 3 vlerësimeve.

Figura 44: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas gjinisë




Sa i përket zonës së banimit, ka pak ndryshim midis treguesit për të anketuarit në zonat rurale dhe urbane, pasi këta të fundit kanë tendencën të jenë më të kënaqur (65% dhe 70%). Gjatë vlerësimeve të shkuara, diferencat kanë qenë të papërfillshme; ndërsa vetëm gjatë kësaj vale vërehet një diferencë e dallueshme.

Figura 45: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas zonës së banimit



Duke marrë parasysh dy grupmoshat, nën dhe mbi moshën 55 vjeç; niveli i kënaqësisë është i njëjtë në të dyja grupet. 68% e të anketuarve të moshës nën dhe mbi 55 vjeç, të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, janë "disi të kënaqur" ose "shumë të kënaqur" me të gjitha institucionet e kontaktuar. Ky nivel i barabartë është arritur pas një rritje të madhe të këtij indikatori krahasuar me vlerësimin e ndërmjetëm për grupmoshën mbi 55 vjeç (+7 pikë përqindje) dhe për grupmoshën nën 55 vjeç (+1 pikë përqindje).

Figure 46: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas moshës




3.3.3 Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike: Komuniteti Rome

Figura 47 tregon rezultatet lidhur me indikatorin e kënaqësisë me shërbimet publike për komunitetin Rom të ndara sipas gjinisë. Në vlerësimin final indikatorin është në nivelin 67%, që do të thotë se nga totali i të anketuarve Romë të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, 67% prej tyre janë "disi të kënaqur" ose "shumë të kënaqur" me të gjitha institucionet e

Rezultatet e vlerësimit final kanë ndryshuar me 1 pikë përqindje krahasuar me atë të ndërmjetëm Krahasuar me popullsinë e përgjithshme (indikatorin e kënaqësisë = 68%) nuk ka shumë ndryshime, duke nënkuptuar kjo një nivel gati identik kënaqësie.


Figura 47: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas gjinisë – Popullsia Rome



3.3.4 Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike: çështje të mëtejshme


Duke marrë në konsideratë nivelin e kënaqësisë me shërbimet publike për kategorinë e qytetarëve që aksesojnë institucionet vetëm përmes ADISA-s ekziston një nivel kënaqësie pothuajse identik me popullsinë në total. Të kombinuara me rezultatet e seksionit 3.2.4 (*aksesi më i lehtë nga ADISA*), rezultatet tregojnë se edhe pse ADISA bën **aplikimin për një shërbim më shpejt (pra akses më i lehtë), marrja e shërbimit varet nga institucioni përgjegjës për atë shërbim**, gjë që nënkupton një nivel identik kënaqësie.

Figura 48: Krahasimi i nivelit të kënaqësisë me shërbimet publike, akses vetëm përmes ADISA




Shpërndarja e indikatorit të kënaqësisë sipas qarqeve ndjek të njëjtin model sikurse ai i lehtësisë së aksesit. Shkodra, në këtë rast ka nivelin më të lartë të kënaqësisë me një rritje te konsiderueshme nga vlerësimi i ndërmjetëm (+21 pikë përqindje), që ndiqet nga Gjirokastra (ndonëse me të njëjtin nivel si në vlerësimin e ndërmjetëm) dhe Lezha. Gjatë vlerësimit të ndërmjetëm dhe final vërehet një rritje në nivelin e kënaqësisë së qytetarëve në pothuajse të gjitha qarqet ku janë ngritur qendra / zyra ADISA. Nga ana tjetër, në Tiranë, Durrës, Kukës, dhe Korçë, vërehet një rënie e nivelit të kënaqësisë.

Figura 49: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas qarkut



Indikatori i kënaqësisë me shërbimet publike merr parasysh vetëm përgjigjet lidhur me “shumë i kënaqur” dhe “deri diku i kënaqur”. Për një analizë më të detajuar të nivelit të kënaqësisë me shërbimet publike, të gjitha përgjigjet si edhe shpërndarja e tyre duhen marrë në konsideratë. Figura 50 paraqet një pamje më të detajuar të përgjigjeve për çdo institucion të përfshirë. Për sa i përket institucioneve, DPGjC ka përqindjen më të lartë (rreth 93%) të të anketuarve që rezultojnë të kënaqur me shërbimet publike (“shumë i kënaqur” dhe “deri diku i kënaqur”), që ndiqet më pas nga QKB me 87% dhe DPShTRr me 84% të të anketuarve. Nga ana tjetër, institucionet me përqindjen më të ulët janë ASHK me vetëm 39% të të anketuarve që shprehin kënaqësi me shërbimet publike, e ndjekur nga SHKP me 57%.

Figura 50: Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike sipas institucioneve



3.3.5 Niveli i kënaqësisë me shërbimet publike: gjetjet cilësore

Në vijim të rezultateve të studimit, ne e shqyrtojmë më tej nivelin e kënaqësisë me shërbimet publike në 2 nivele të tjera. Në nivelin fillestar (bazë) në shohim cilësitë operacionale të shërbimeve publike për të parë se si cilësia e shërbimit përkthehet në kënaqësi lidhur me të. Kjo e bën kënaqësinë një proces mekanik që ka të bëjë me ndërveprimin midis shërbimeve dhe qytetarit. Ne gjithashtu e zgjerojmë më tej nivelin e kënaqësisë së qytetarëve mbi shërbimet publike duke përfshirë pritshmëri dhe qasjen e tyre ndaj shërbimit, për të parë se si kjo ndikon më vonë në nivelin e kënaqësisë. Pra kjo qasje nënkupton jo vetëm marrjen parasysh të vlerës së shërbimit që ofrohet, por konceptin i çfarë pritjet në lidhje me shërbimin që ofrohet.



Unë mendoj se ata (institucionet) japin informacion të qartë, por personi duhet të jetë i qartë paraprakisht për atë që do, në mënyrë që të mos përfundojë në institucionin e gabuar.



Femër, 48 vjeç., Tiranë, zonë rurale

Por qytetarët e informuar (edhe kur i përkasin grupeve të marxhinalizuara) pretendojnë se kanë marrë shërbimin e premtuar.

“

Unë mendoj se nëse jeni i mirë informuar, nëse tregoni pak vendosmëri, ju do ta merrni informacionin normalisht. Më tej, një gjë që duhet të mësojmë lidhet me faktin që ne duhet të kuptojmë më mirë rolin e institucioneve të tjera, për shembull kur ka 2-3 institucione përgjegjëse për shërbimin tënd...

”

Ajo pati përvojë me një nga institucionet më të vështira për të marrë një shërbim publik, i cili mendohet si shumë i korruptuar nga të gjithë personat që e kanë kontaktuar atë, pra më përpara ZRPP dhe ALUIZNI, tani ASHK

Femër, 27 vjeç., Tiranë, zonë urbane, Komuniteti Rom

Lidhur me shpejtësinë e ofrimit të shërbimit, ekziston një perceptim më pozitiv lidhur me procesin e ofrimit të shërbimit, kryesisht për marrjen e dokumenteve bazë (si p.sh. certifikatë personale, e cila sikurse u përmend nga të gjithë pjesëmarrësit donte vetëm pak minuta për tu nxjerrë nga e-Albania), si edhe shërbimeve më të komplikuar (si p.sh. aplikimi për të marrë një kartë identiteti). Sidoqoftë, ka disa shërbime specifike të ASHK të cilat shumë shpesh lidhen me sjellje korruptive. Sjella (sikurse shprehen pjesëmarrësit e grupeve të diskutimit) lidhet me përpjekjet e punonjësve të këtij institucioni për të zgjatur kohën e dhënies së – duke pritur ryshfet për të mbajtur procesin të hapur.

“

Unë, sikurse tha zotëria përpara meje, kam aplikuar për një kartë identiteti. Dhe në mënyrë të ngjashme, bëri aplikimin përmes telefonit (e-Albania) – vajta për ta marrë në datën dhe kohën e caktuar dhe nuk kishte vonesa fare.

”

*Gjithsesi, kur pyetet rreth procesit të aplikimit përmes telefonit, ajo sqaron se vajti në bashki dhe një punonjës i plotësoi aplikimin për llogari të saj – duke nënkuptuar që ai hapi një llogari në emër të saj dhe procedoi me bërjen e aplikimit.

Femër, 49 vjeç ., Korçë, zonë urbane

“

ADISA ofron një zgjidhje shumë të mirë dhe të shpejtë ... Edhe pse aplikimi bëhet online, shërbimi merret përmes ADISA-s, më shumë për qytetarët që janë mbi 50 vjeç dhe kanë vështirësi në përdorimin e telefonit inteligjent, internetit ose e-Albania-s, ata mund të shkojnë tek ADISA dhe të bëjnë menjëherë aplikimin. Normalisht, është shumë më mirë pasi personit nuk i duhet të vijë vërdallë nëpër Tiranë për të gjetur institucionin e duhur, por shkon tek ADISA për ta marrë atë.

*Grupi rural në Tiranë shpeshherë akseson (disa nga pjesëmarrësit)
ADISA-n në zonën e Kombinatit,*



Femër, 26 vjeç ., Tiranë, zonë rurale



*Moderatori pyet se si është situata tani që ADISA është hapur në
qytet*: *Tani ju mund ti arrini gjërat më shpejt.*



Femër, 28 vjeç ., Shkodër, zonë urbane

Më tej në vëzhguam që kënaqësia lidhet më shumë me procesin e aplikimit se sa me marrjen e shërbimit. Kjo lidhet me një nga komponentët e kënaqësisë, i cili është ofrimi i shërbimit të premtuar (veçanërisht duke njohur më parë kohën e ofrimit), si edhe me një proces të përsheptuar, të paktën për shërbimet kryesore.

4 Përvoja me Institucionet Publike


4.1 Vlerësimi i attributeve të shërbimit

4.1.1 Vlerësimi i përgjithshëm i attributeve

Aftësia për të vlerësuar performancën është me rëndësi kritike në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike. Përfshirja e shumë dimensioneve të performancës së përgjithshme lejon që të përqendrohemi në pjesë specifike të procesit dhe të vlerësojmë secilën prej tyre në përputhje me rrethanat. Në një shkallë Likert prej 1 deri në 5, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin atributet që karakterizojnë ofrimin e shërbimeve publike. Më pas shkalla transformohet në një shkallë 0 – 100, për ta bërë më të lehtë krahasimin. Figura 51 tregon rezultatet e agreguara të vlerësimit të attributeve që të anketuarit dhanë për tetë institucione (ASHK, QKB, ISSH, DPSHTRr, FSDKSh, DPGjC, DPT dhe SHKP).

Lexueshmëria e formave është dimension i vlerësuar më shumë, duke marrë 84 pikë nga 100, pasuar nga orët e përshtatshme të punës që merr 82 pikë dhe sjelljen dhe komunikimin e stafit me 80 pikë. dhe vendndodhja e duhur e zyrës me 77 pikë. Shpejtësia e përpunimit dhe drejtësia / paanësia janë dimensionet e vlerësuara më pak (përkatësisht 72 dhe 75 pikë) – ndonëse të dyja janë vlerësuar shumë. Krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, pothuajse të gjitha atributet kanë marrë një vlerësim në rritje, përveç Lexueshmërisë së formave (nga 85 në 84 pikë) dhe vendndodhjes së përshtatshme të zyrave (nga 77 në 76 pikë).

Figura 51: Vlerësimi i attributeve



Gjithashtu, kur u pyetën se si i zbuluan procedurat ndihmuese, rezultatet e përgjithshme tregojnë se qytetarët vazhdojnë të mbështeten në kontaktimin e drejtpërdrejtë me funksionarët për të mësuar rreth procedurave. Rezultati është pak i ulët (56%) në vlerësimin final. Qytetarët gjithashtu vazhdojnë të mbështeten tek përshkrimet e miqve, të afërmeve, fqinjëve apo personave të tjerë të afërt, për t'u informuar rreth procedurave, një rezultat i cili është i ulët (32%) në krahasim me vlerësimin e ndërmjetëm. Sidoqoftë, mbështetja në faqen e internetit të departamentit ose faqe të tjera duket e lartë (4%) për shkak të përmirësimeve të bëra në reflektimin e informacionit përmes këtyre kanaleve. Duke i ndarë sipas kategorive që preken, siç është popullsia femërore, grupmosha mbi 55 vjeç ose popullsia rurale, rezultatet e paraqitura në Figurën 53 nuk tregojnë dallime të rëndësishme kur krahasohen me rezultatet e përgjithshme.

Figura 52: Si u informove mbi procedurën e përdorimit të shërbimit? (Përgjigje e shumëfishtë) – Popullsia e përgjithshme





Figura 53: Si u informove mbi procedurën e përdorimit të shërbimit? (Përgjigje e shumëfishtë) – Sipas kategorive




4.1.2 Transparenca

Për të analizuar çdo atribut në detaje, janë paraqitur rezultatet për modelin e përgjithshëm për dhjetë institucionet më të kontaktuara dhe për shtresën e varfër. Kur merret në konsideratë shtresa e përgjithshme, transparenca vlerësohet më e lartë tek DPGJC, FSDKSh dhe DPT, përkatësisht 85, 80 dhe 79.7 pikë. ASHK dhe SHKP vlerësohen si më pak transparente në vlerësimin final, përkatësisht me 52 dhe 66 pikë.

Krahasuar me vlerësimin e ndërmjetëm, përveç ASHK, FSDKSH dhe DPGJC, transparenca është rritur për institucionet e tjera. Përmirësime të dukshme në transparencë janë bërë nga DPT, nga 72 në 80 pikë.

Për rezultatet e vlerësimit final, vlerësimi i transparencës është pak më i lartë për shtresën e varfër (+1 pikë) në nivel të përgjithshëm. Ndryshime të rëndësishme përfshin DPT, e cila vlerësohet me 94 pikë nga shtresa më e varfër dhe 80 nga ajo e përgjithshme dhe DPGJC e cila vlerësohet me 87 pikë nga shtresa më e varfër dhe 85 pikë nga ajo e përgjithshme.

Figura 54: Vlerësimi i transparencës – popullsia e përgjithshme dhe e varfër



*Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra e papërfillshme dhe nuk mund të merret në konsideratë gjatë analizës.

4.1.3 Përgjegjësia

Përgjegjësia përfshin detyrimin për të dhënë informacion në lidhje me performancën, shpjegimin e vendimmarrjes dhe për të justifikuar sjelljen. Me këtë nënkuptohen rastet kur qytetarët pyesin lidhur me procesin dhe nëpunësit publikë mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Rezultatet e vlerësimit final nuk tregojnë ndryshime (në total) në vlerësimin e përgjegjësive së shtresës së ulët dhe popullsisë së përgjithshme. DPSHTRr, DPGJC, DPT vlerësohen nga shtresa e ulët me të paktën 2 pikë më shumë se sa popullsia e përgjithshme, ndërsa institucionet e tjera kanë marrë pikë më të ulëta.

Figura 55 tregon rezultatet e vlerësimit të përgjegjësive për vlerësimin bazë, vlerësimin e ndërmjetëm dhe atë final.

Në përgjithësi, të anketuarit vlerësuan DPGJC-në, FSDKSh-në dhe DPT-në si institucionet më të përgjegjshme, që u vlerësuan respektivisht me 85, 79.9 dhe 79.6 pikë. ASHK dhe SHKP vlerësohen si institucione më pak të përgjegjshme, duke marrë 54 dhe 68 pikë respektivisht. Kur krahasohen me vlerësimin e ndërmjetëm, rezultatet e vlerësimit final janë më të larta për ISSH, DPSHTRr dhe SHKP, ndërsa ASHK, FSDKSh dhe DPGJC kanë marrë një rezultat më të ulët.

Rezultatet final nuk shfaqin ndryshime (në total) në vlerësimin e përgjegjshmërinë nga shtresa e ulët dhe ajo e përgjithshme. DPSHTRr, DPGJC, DPT vlerësohen nga shtresa e ulët me të paktën 2 pikë më shumë se nga ajo e përgjithshme, ndërsa institucionet e tjera kanë marrë një vlerësim më të ulët.

Figura 55: Vlerësimi i përgjegjësive – popullsia e përgjithshme dhe e varfër



*Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës.

4.1.4 Drejtësia/ Paanësia

Drejtësia në ofrimin e shërbimeve publike përfaqëson trajtimin ose sjelljen e paanshme dhe të drejtë, pa favorizim apo diskriminim ndaj qytetarëve. Figura 56 tregon vlerësimin e drejtësisë për vlerësimin bazë, atë të ndërmjetëm dhe final. Qytetarët vlerësojnë si institucione më të drejta DPGjC-në, DPSHTRr-në dhe FSDKSh-në, të cilat respektivisht kanë 84, 76.8 dhe 77.4 pikë. Institucionet më pak të vlerësuara si të drejta janë, si në dimensionet e mëparshme janë ASHK dhe SHKP me 52 dhe 63 pikë respektivisht.

Shumica e institucioneve kanë marrë një vlerësim më të ulët në drejtësi në vlerësimin final krahasuar me atë të ndërmjetëm dhe siç vërehet më parë, FSDKSH ka një ulje më të madhe. Vetëm DPSHTRR vlerësohet si më e drejtë në vlerësimin final, rezultati i së cilës është rritur nga 72 në 77 pikë.

Rezultatet finale tregojnë se shtresa e ulët e vlerëson drejtësinë në ofrimin e shërbimeve publike si më të lartë se shtresa e përgjithshme, cila përgjithësisht llogaritet 1 pikë më e lartë. DPT vlerësohet me 18 pikë më shumë nga shtresa e ulët.

Figura 56: Vlerësimi i drejtësisë – popullsia e përgjithshme dhe e varfër




*Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës.

4.1.5 Shpejtësia e përpunimit të procedurave

Shpejtësia e përpunimit ka marrë 70 pikë nga 100 pikë në total. Kryesisht disa institucione kanë marrë një vlerësim veçanërisht të ulët, si p.sh. ASHK që ka marrë 39 nga 100 dhe SHKP që ka marrë 62 nga 100, edhe pse të dy përmirësuan pak rezultatin e vlerësimit të ndërmjetëm. Sidoqoftë, ky rezultat i ulët për ASHK gjithashtu mund të lidhet me natyrën e shërbimit që ato ofrojnë, pasi vështirësia në trajtimin e çështjeve të pronës së paluajtshme mund të jetë shumë më e lartë se sa për çështjet që kanë të bëjnë me institucionet e tjera.

Për këtë arsye, DPGJC dhe FSDKSh vlerësohen se kanë një shpejtësi të lartë përpunimi, ndërsa duke marrë parasysh vlerësimin e ndërmjetëm, rezultatet e vlerësimit final tregojnë një përmirësim të shpejtësisë së përpunimit për gjysmën e institucioneve, SHKP, ISSH, DPSHTRr, DPT, e cila është rritur me të paktën 2 pikë.

Figura 57: Vlerësimi i shpejtësisë së përpunimit të procedurave – popullsia e përgjithshme dhe e varfër




* Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës.

4.1.6 Saktësia e shërbimit

Saktësia e shërbimeve ka marrë një vlerësim relativisht të lartë nga të anketuarit. Si më të sakta janë vlerësuar shërbimet e DPSHTRr-së dhe DPGjC-së, që kanë marrë 82 dhe 86 pikë respektivisht. Shumica e institucioneve të tjera morën më shumë se 70 pikë, përveç ASHK-së që mori 54 pikë. Sidoqoftë, krahasuar me vlerësimin e ndërmjetëm FSKKSH ka marrë një vlerësim të ulët, duke rënë me 8 pikë.

Në përgjithësi, shtresa më e varfër e vlerëson pak më shumë saktësinë e shërbimeve se rezultati i përgjithshëm, me 1 pikë, por ky rezultat mund të jetë i lidhur me nivelin e pritshmërisë nga shërbimi. Në këtë rast, DPT dhe DPQJC kanë marrë 96 dhe 88 pikë respektivisht nga shtresa më e varfër, gjë që tregon se për këtë grup shërbimet e marra nga DPT dhe DPGjC kanë një shkallë të lartë saktësie.

Figura 58: Vlerësimi i saktësisë së shërbimit – popullsia e përgjithshme dhe e varfër



* Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës.

4.1.7 Lexueshmëria e formularëve⁵

Lexueshmëria e formularëve (madhësia dhe shkronja të përshtatshme) është vlerësuar më shumë midis të gjitha attributeve, duke marrë një rezultat të përgjithshëm prej 84 nga 100. Më në detaje, DPSHTRr dhe DPGjC morën vlerësimin më të lartë në rezultatin e vlerësimit final, respektivisht 86 dhe 87 pikë, ndërkohë që shumica e institucioneve kanë marrë më shumë se 80 pikë, ASHK-së.

Krahasuar me vlerësimin e ndërmjetëm, vërehen dallime të vogla për shumicën e institucioneve. Megjithatë ka një rënie në vlerësimin e SHKP-së me 5 pikë. Duke pasur parasysh shtresën e varfër, ka shumë pak dallime nga rezultati i përgjithshëm, me përjashtim të DPT që ka 10 pikë më shumë.

Figura 59: Vlerësimi i lexueshmërisë së formularëve – popullsia e përgjithshme dhe e varfër



* Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës.

⁵ FSDKSH pranon se aplikimi nuk kërkon një formular për tu plotësuar – të gjitha të dhënat e nevojshme plotësohen paraprakisht teksa aplikohet online.

4.1.8 Përshtatshmëria e orarit të punës dhe e vendndodhjes së zyrës

Në përgjithësi, të anketuarit i vlerësojnë orët e punës si të përshtatshme, me shumicën e institucioneve që marrin më shumë se 79 pikë. Rezultatet e vlerësimit të fundit tregojnë një përmirësim të përgjithshëm lidhur me orët e punës, por ka disa institucione që kanë marrë rezultate më të ulëta, siç janë FSDKSH dhe DPGJC. Për më tepër, nuk ka dallime të konsiderueshme midis rezultateve nga shtresa më e varfër dhe rezultatit të përgjithshëm, duke përjashtuar një vlerësim më të lartë lidhur me orët e punës për DPT (+14 pikë).

Figura 60: Vlerësimi i orarit të përshtatshëm të punës – popullsia e përgjithshme dhe e varfër




* Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës

Figura 61 tregon vlerësimin e të anketuarve lidhur me vendndodhjen e zyrës së institucionit. Vendndodhja e zyrës mori nota të ulëta për të gjitha institucionet, përveç DPT-së dhe SHKP-së, vlerësimet e të cilave u rritën me 6 dhe 5 pikë, respektivisht.

Nuk ka ndryshime të konsiderueshme ndërmjet shtresës së ulët dhe pikëve të përgjithshme për shumicën e institucioneve, përveç vlerësimit më të lartë për DTP (+12 pikë) nga shtresa e ulët – që konsiderohet si vlerësimi më i lartë i institucionit për këtë grup.

Figura 61: Vlerësimi i vendndodhjes së zyrave – popullsia e përgjithshme dhe e varfër




* Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës

4.1.9 Sjellja dhe komunikimi i stafit

Vlerësimi i mëposhtëm ka të bëjë me etikën e përgjithshme të punës në agjencitë publike, ose grupin e vlerave, të cilat përfshijnë qëndrimin e duhur, sjelljen korrekte, respektin për të tjerët dhe komunikimin efektiv në vendin e punës. Në thelb, etika e punës pasqyron atë se çfarë një punonjës do të bënte në situata të ndryshme gjatë ofrimit të shërbimeve publike.

Të anketuarit vlerësuan pozitivisht sjelljen dhe komunikimin e stafit, pasi secili institucion mori 71 pikë ose më shumë. DPGjC mori vlerësimin më të lartë, respektivisht 85 nga 100 pikë, ndërsa ASHK mori rezultatin më të ulët, 71 pikë. Krahasuar me vlerësimin e ndërmjetëm, FSDKSH pësoi rënien më të madhe, me 10 pikë. Për më tepër, nuk ka dallime të rëndësishme në rezultatet e përgjithshëm të të gjitha institucioneve, përveç DPT-së që mori 15 pikë më shumë nga shtresa e ulët. Shtresa më e varfër e ka vlerësuar këtë atribut më shumë për shumicën e institucioneve.

Figura 62: Vlerësimi i sjelljes dhe komunikimit të stafit




* Ka vetëm një përgjigje për QKB – pra jo-domethënëse dhe nuk merret parasysh gjatë analizës

4.2 Përvoja me ankesat

4.2.1 Arsyet për tu ankuar

Përvoja me ankesat është një element tregues i cilësisë së shërbimit publik, pasi qytetarët vlerësojnë të gjithë dimensionin e një shërbimi publik dhe kujtojnë se njëri prej tyre nuk ishte në standardin e dëshirueshëm. Përvoja me ankesat ndahet në vlerësimin e qytetarëve që kanë arsye për t'u ankuar dhe atyre që në fakt kanë bërë ankesën.

Figura 63: A keni pasur ndonjë arsye për t'u ankuar? (Vetëm ata që kanë kontaktuar të paktën një institucion)




Rezultatet e vlerësimit final tregojnë se rreth 14% e qytetarëve të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, kanë pasur arsye për t'u ankuar për shërbimin e marrë. Megjithatë, vetëm 3% e të anketuarve që kanë

kontaktuar të paktën një institucion, kanë dorëzuar një ankesë. Për këtë rast, ka shumë arsye të cilat i adresojmë më tej gjatë këtij seksioni. Krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, ku 14% e të anketuarve që kanë kontaktuar të paktën një institucion, kanë pasur një arsye për t'u ankuar, ka një rënie prej 1 pikë përqindjeje. Edhe në vlerësimin e ndërmjetëm, përqindja e qytetarëve të cilët kanë dorëzuar një ankesë është dukshëm më e ulët se ata që kishin arsye për t'u ankuar, përkatësisht 5%.

Për më tepër, figura 64 tregon përqindjen e qytetarëve që kanë arsye për t'u ankuar për shërbimin që kanë marrë, e ndarë sipas institucioneve, në të cilën pasqyrohen institucionet më të kontaktuar. Rezultatet e vlerësimit final tregojnë se ASHK ka përqindjen më të lartë të arsyeve për t'u ankuar, pasi në rreth 40% të rasteve, qytetarët që kanë kontaktuar institucionin, kanë pasur arsye për t'u ankuar për shërbimin që kanë marrë. SHKP është e dyta, pasi në 18% të rasteve, qytetarët të cilët kanë kontaktuar institucionin, kanë pasur arsye për t'u ankuar për shërbimin që kanë marrë. Gjithashtu duke marrë parasysh numrin e kontakteve që këto institucione kanë, në total ASSHK ka numrin më të lartë të rasteve në të cilat qytetarët kanë pasur arsye për t'u ankuar (80 pikë kundrejt 14 pikë të SHKP).

Nga ana tjetër, DPGjC, DPSHTRr dhe DPT kanë përqindjen më të vogël të qytetarëve që kanë pasur arsye për t'u ankuar për shërbimin që kanë marrë, që konsiston respektivisht në 3%, 5% dhe 6.7% dhe duke marrë parasysh numrin e kontakteve, DPT ka rastet më të ulëta kur qytetarët kanë pasur arsye për t'u ankuar. Krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, vërehet një rritje e konsiderueshme e arsyeve për tu ankuar për ASHK, me rreth 12 pikë përqindjeje. Rezultatet nxjerrin në pah si ulje ashtu edhe ngritje të lehta të arsyeve për tu ankuar për institucionet, ku mund të përmendim: QKB (+5pp); DPSHTRr (+2pp); ISSH (-2pp); DPT (-2pp).


Figura 64: A keni pasur ndonjë arsye për t'u ankuar? – E ndarë sipas institucioneve (Vetëm ata që kanë kontaktuar të paktën një institucion)



4.2.2 Ankesat e bëra


Përveç vlerësimit të arsyeve për t'u ankuar, ne gjithashtu shqyrtojmë ankesat aktuale që qytetarët kanë deklaruar për secilin institucion. Rezultatet e vlerësimit final tregojnë se për ASHK-në, nga 80 qytetarë që u ankuan, 14 dorëzuan ankesën. Për ISSH, nga 27 persona që kishin arsye për t'u ankuar, vetëm 8 dorëzuan një ankesë. Institucione të tjera kanë një nivel shumë të ulët ankesash, të kryera si për vlerësimin final, edhe për atë të ndërmjetëm. Kryesisht ka një rënie domethënëse të ankesave për ISSH.

Figura 65: Numri i rasteve kur qytetarët kanë paraqitur një ankesë




Për ata qytetarë që kanë pasur arsye për t'u ankuar pasi kanë kontaktuar një institucion gjatë 12 muajve të fundit, por nuk kanë mundur ta bëjnë këtë, rezultatet tregojnë se arsyeja më e përmendur është se ata nuk besonin se institucioni do ta zgjidhte problemin (55%), që është edhe më i lartë se rezultati i vlerësimit të ndërmjetëm. Për më tepër, qytetarët listuan si arsye të dytë se nuk dinin se ku duhet të ankoheshin (19%), por në këtë rast rezultati ka rënë pak nga vlerësimi i ndërmjetëm. Çuditërisht, disa nga të anketuarit vendosën të deklarojnë se nuk e dinin procedurën për të paraqitur një ankesë, duke ditur se ka alternativa të qarta për ta bërë këtë gjë në institucionet publike, siç është platforma "Shqipëria që duam"

Figura 66: Pse nuk paraqite një ankesë nëse kishë arsye për ta bërë diçka të tillë?



Të pyetur për platformën e bashkëqeverisjes (Shqipëria që duam), 67% e kampionit të përgjithshëm kanë deklaruar se kanë njohuri për këtë platformë, ndërsa vetëm 13% e tyre e kanë përdorur atë në 12 muajt e fundit. Qytetarët të cilët e kishin përdorur platformën e bashkëqeverisjes, u pyetën që të vlerësonin në një shkallë prej 1 deri në 5 nivelin e tyre të kënaqësisë. Transformuar në një shkallë nga 0 në 100, ku 0 është shumë të pakënaqur dhe 100 është shumë të kënaqur, vlerësimi i përgjithshëm i platformës është 66, duke treguar një kënaqësi më të madhe me platformën krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm (57 nga 100).

Figura 67: Platforma e bashkëqeverisjes "Shqipëria që duam"



4.2.3 Përvoja me ankesat: gjetjet cilësore

Pjesëmarrësit e grupeve të diskutimit në përgjithësi janë në dijeni të zgjedhjeve të ndryshme që kanë për të bërë ankesa që jep një perceptim të përgjithshëm pozitiv lidhur me procesin e reagimeve lidhur me ofrimin e shërbimeve publike. Gjithsesi, rastet e këtyre ankesave që zgjidhen janë të kufizuara duke i dekurajuar qytetarët nga ndjekja e këtij procesi (nëse është i nevojshëm).



..Unë bëra një ankesë në Zyrën e Punës tre javë më parë. Aplikova për një sesion trajnimi profesional përmes e-Albania dhe shkova në Zyrën e Punës për të marrë një dokument për regjistrim në Qendrën e Trajnimit Nr. 4. Gjatë ndërveprimit tim me punonjësin, një mik i saj erdhi dhe u ul atje për të më shumë se një orë duke diskutuar çështje personale. Bëra një ankesë për këtë dhe e vendosa letrën e ankesës në kutinë specifike. kalova pranë një disa ditë më parë, dhe letra ime e ankesës ishte ende brenda në atë kuti. Nuk kam shpresë se dikush do ta lexojë.



Man, 27 y.o, Tirana, Roma Community

“

Unë kam parë që platforma “Shqipëria që duam” është një zgjidhje për procedurën e ankesave. Unë kam ndihmuar njerëz për llogaritjen e skemës së pensionit. Ato kanë pasur probleme me llogaritjen prej vitesh. Ata kanë ndjekur çdo procedurë të mundshme përmes institucioneve dhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Kur aplikuam në platformë përmes llogarisë së tyre në e-Albania, ata gjetën zgjidhje si edhe morën paratë për vitet e llogaritura gabim.

”

Femër, 30 vjeç, Tiranë, zonë rurale

“

Tashme, të gjitha institucionet i vënë në dispozicion qytetarëve një kuti për ankesat që ata mund të kenë për shërbimet e tyre. Ne i kemi parë që ato kuti janë plot me ankesa, por këto të fundit nuk shkojnë tek sektorët e caktuar.

”

Femër, 26 vjeç, Korçë, zonë rurale

“

Ju mund të përdorni ADISA-n për çdo ankesë të mundshme që mund të keni për institucionet që ofrojnë shërbime.

”

Femër, 25 vjeç, Shkodër, zonë urbane

“

Ekziston një portal bashkëqeverisje për procedurën e ankesës edhe pse unë nuk e kam përdorur atë.

”

Femër, 27 vjeç, Shkodër, zonë rurale

4.3 Përvoja me korrupsionin


4.3.1 Përvoja personale me korrupsionin

Korrupsioni është një përvojë shumëdimensionale, prandaj në vlerësimin e përvojës së korrupsionit kur merr një shërbim, veprimi është ngushtuar në kërkesën ose nënkuptimin e një ryshfeti, pasi qytetarët morën shërbimin. Pas vlerësimit të përvojës personale me korrupsionin e vetëm të anketuarve që kanë kontaktuar me të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, u shqyrtua perceptimi i korrupsionit për të gjithë kampionin, detajuar sipas institucionit dhe llojit të kontaktit.

Rezultatet tregojnë se në rreth 9% të rasteve kur qytetarët i kontaktuan institucionet, një ryshfet u kërkua ose u nënkuptua të paktën në njërin prej institucioneve të kontaktuara. Përvoja me korrupsionin vazhdon të mbetet në të njëjtin nivel si në vlerësimin e ndërmjetëm. Duke marrë parasysh institucionet, qytetarët të cilët kanë kontaktuar ASHK, në 29% të rasteve kanë deklaruar se është kërkuar ose nënkuptuar një ryshfet, ndërsa DPSHTRr vijon me 13% të rasteve që qytetarët kanë kontaktuar me institucionin. Institucionet e tjera të përfshira kanë një nivel nën 13%, ndërsa mund të vërehet se DPGJC dhe QKB kanë rreth 2% të rasteve.


Në krahasim me vlerësimin e ndërmjetëm, DPSHTRr, ASHK, FSDKSH dhe SHKP tregojnë një rritje në nivelin e korrupsionit, pasi përqindja në rritje e rasteve është më e madhe për ASHK dhe FSDKSH, e moderuar për SHKP dhe e vogël për DPSHTRr. Në lidhje me rritjen e FSDKSH, nga 158 të anketuar të cilët kanë kontaktuar këtë institucion, 16 prej tyre (10%) deklarojnë se një ryshfet ju kërkuar (3 raste) ose nënkuptua (13 pacientë). Gjithsesi, duke shqyrtuar më tej të dhënat, nga 16 raste, 14 gjenden në Tiranë, 1 në Kukës dhe 1 në Durrës – duke nxjerrë në pah raste më të shumta në Tiranë.

Figura 68: Gjatë kontaktit tuaj me institucionin, është nënkuptuar (ose u është kërkuar) në ndonjë moment që ju duhet të jepnit ryshfet për të marrë shërbimin?




Për të shqyrtuar më tej çështjen, të anketuarit të cilët deklaruan se një ryshfet u kërkua ose u nënkuptua, iu kërkua të tregonte qëllimin e tij. Shumica e tyre përmendën përsheptimin e procesit si qëllimin kryesor të ryshfetit (75%). Qëllimet e mëtejshme përfshijnë mundësimin e ofrimit të shërbimit pa rradhë (37%) dhe mundësia për të marrë trajtim preferencial nga zyrtarët (41%). Rezultatet e vlerësimit final lidhur me ryshfetin e kërkuar ose të nënkuptuar janë shumë të ndryshme nga rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, gjë që tregon rritje të korrupsionit në institucionet publike.

Figura 69: Për çfarë qëllimi është paguar ryshfeti? (lejohen shumë përgjigje)



4.3.2 Perceptimi i korrupsionit

Figura 70 tregon përqindjen e të anketuarve që kanë kontaktuar me institucionet publike dhe kanë pasur ose nuk kanë pasur përvojë në korrupsion dhe përqindjen e të anketuarve që nuk kanë pasur kontakt me institucionet. Rezultatet tregojnë se 7% e qytetarëve kanë kontaktuar me institucionet publike dhe kanë pasur përvoja me korrupsionin, ndërsa 52% kanë kontaktuar me institucionet publike, por nuk kanë pasur përvojë me korrupsionin, dhe më në fund 41% nuk kanë kontaktuar fare institucionet. Përqindja e të anketuarve që kanë hasur raste korruptive është më e ulët se mesatarja e rasteve të përgjithshme (9% - Figura 68), duke nënkuptuar që pak të anketuar kanë pasur më shumë se një eksperiencë. Më tej ne i përdorim këto rezultate për të krahasuar perceptimet e këtyre kategorive mbi korrupsionin. Për të vlerësuar një nivel të përgjithshëm të perceptimit, qoftë nga përvoja personale apo nga kanale të tjera informacioni, të anketuarve u është




kërkuar të vlerësojnë nivelin e korrupsionit për të gjitha institucionet në një nivel nga 1 në 5. Transformuar në një shkallë nga 0 në 100, Figura 71 më poshtë tregon rezultatin e vlerësimit të korrupsionit.

Në përgjithësi, ata që kanë kontaktuar të paktën një institucion gjatë 12 muajve të fundit, por nuk kanë pasur përvojë me korrupsionin (52%), e vlerësojnë korrupsionin në 46 nga 100 pikë. Ata të anketuar që kanë kontaktuar me institucionin publik dhe kanë pasur përvojë me korrupsionin (7%) japin një normë më të lartë për korrupsion (59 nga 100). Ata që nuk kanë kontaktuar ndonjë institucion gjatë 12 muajve të fundit (41%) vlerësojnë korrupsionin në institucionet e synuara me 52 nga 100 pikë.

Krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, vlerësimi i korrupsionit është rritur me 2 pikë në vlerësimin final. Kjo rritje e lehtë tregon një këmbëngulje në perceptimin se korrupsioni është i pranishëm në agjencitë publike, i cili gjithashtu mbështet gjetjet e korrupsionit nga përvoja personale në fillim të seksionit.

Figura 71: Si do ta vlerësonit nivelin e korrupsionit në institucione? – Sipas përvojës me korrupsionin



Edhe kur merret parasysh lloji i kontaktit, normat bien pothuajse në të njëjtën sasi, duke treguar qëndrueshmëri në vlerësimin ndërmjet grupeve të kontaktit.


Megjithatë, duhet theksuar se si mungesa e përvojës personale me korrupsionin përbëhet vetëm nga rënia e moderuar në vlerësimin e korrupsionit nga të anketuarit. Në këtë rast, perceptimi i përgjithshëm i korrupsionit, i cili është krijuar kryesisht përmes kanaleve të shumta të kontaktit të përditshëm, si nëpërmjet mediave, miqve dhe familjes ose kolegët e punës, kanë një ndikim të rëndësishëm dhe negativ në vlerësimin e korrupsionit edhe të qytetarët që kanë kontaktuar me institucionet nuk kanë patur përvojë me vetë korrupsionin. Për më tepër, kjo mund të shpjegojë vlerësimin e qytetarëve që kanë pasur kontakte me institucionet dhe nuk kanë përjetuar korrupsionin, por e perceptojnë korrupsionin në institucionet e tjera me të cilat nuk kanë kontaktuar.

Nga një këndvështrim tjetër, Figura 72 tregon rezultatet e vlerësimit të korrupsionit bazuar në një shkallë 1-5 dhe të zbrëthyer nga fakti nëse të intervistuarit kanë kontaktuar apo jo një institucion gjatë 12 muajve të fundit. Rezultatet finale tregojnë se ata që nuk kanë pasur kontakt me institucionin vlerësojnë një

normë më të lartë të korrupsionit krahasuar me ata që kanë kontaktuar me ndonjë. Ky përfundim mbështet pohimin se perceptimi i përgjithshëm i korrupsionit në institucione është një përcaktues i rëndësishëm në vlerësimin e korrupsionit nga ana e qytetarëve. Përveç kësaj, rezultatet për të anketuarit të cilët nuk kanë kontaktuar kanë ndryshim të vogël në vlerësimin e ndërmjetëm dhe atë final, ndërsa për të anketuarit të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion, rezultatet finale paraqiten pak më të larta.

Renditjet finale të institucioneve tregojnë se ekziston një perceptim i lartë i sjelljeve të korrupsionit në ASHK, DPT dhe DPSHTRr, pasi institucionet janë më të përmendurat nga qytetarët për nivelin e tyre të korrupsionit. Duke marrë parasysh vetëm vlerësimin e atyre të anketuarve që kanë kontaktuar të paktën një institucion, rritet shkalla e korrupsionit në të gjitha institucionet e listuara, e cila paraqitet në shkallë më të lartë për QKB dhe FSDKSH.

Figura 72: Si do ta vlerësonit nivelin e korrupsionit në këtë institucion (Nëse e keni kontaktuar ose jo) ?



Kur vlerësohet korrupsioni, është gjithashtu e rëndësishme të shihen vlerësimet "e larta" dhe "shumë të larta", të cilat janë më indikative për të përcaktuar nëse qytetarët janë të sigurt për përvojën e tyre me korrupsionin ose të bindur në perceptimin e tyre rreth korrupsionit. Figura 73 tregon rezultatet e përqindjes së vlerësimeve "të larta" dhe "shumë të larta" të vlerësimit total të bërë për një institucion. ATP ka përqindjen më të madhe të qytetarëve që japin vlerësim të lartë për korrupsion, pasi 54% e tyre e vlerësuan korrupsionin në institucione si "të lartë" ose "shumë të lartë". Menjëherë më pas ajo ndiqet nga

DPDog dhe ASHK të cilat kanë një përqindje prej 53% dhe 45% respektivisht. Gjatë gjithë vlerësimit, rezultatet tregojnë se këto dy institucione kanë një nivel të lartë të korrupsionit.

Për më tepër, DPT ka një përqindje të madhe të qytetarëve që vlerësojnë korrupsionin e institucionit si "të lartë" ose "shumë të lartë", veçanërisht 40%, ndërsa institucionet e tjera janë nën nivelin prej 40%. ISSH, FSDKSH dhe DPGJ kanë nivelin më të ulët të korrupsionit duke marrë parasysh përqindjen e qytetarëve që e vlerësojnë gjendjen e korrupsionit si "të lartë" ose "shumë të lartë", përkatësisht me 22% dhe 10%.

Krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm, vërehet një rritje e nivelit të korrupsionit për ATP, por një rënie e nivelit të korrupsionit për DPDog dhe ASHK. Ndërsa për shumicën e institucioneve të tjera, qytetarët vlerësuan praninë e korrupsionit më të lartë se gjatë vlerësimit të ndërmjetëm, me ndryshime të konsiderueshme në shumë prej tyre.

Figura 73: Përqindja e vlerësimeve "të larta" dhe "shumë të larta" të nivelit të korrupsionit në institucion (duke marrë parasysh vetëm përgjigjet e kualifikuara)




Figura 74 dhe Figura 75 ofrojnë një pasqyrë më të detajuar dhe më të plotë të vlerësimit të korrupsionit, për qytetarët të cilët kanë kontaktuar të paktën një institucion dhe ata që nuk kanë, renditur sipas përqindjes së atyre që e vlerësuan korrupsionin si "të ulët" ose "shumë të ulët ". Të anketuarit të cilët kanë pasur kontakt me të paktën një institucion, vlerësuan DPGJC, FSDKSH dhe ISSH si më pak të korruptuar, ndërkohë që edhe të anketuarit të cilët nuk kanë pasur kontakt me ndonjë institucion vlerësuan DPGJC, FSDKSH dhe ISSH si më pak të korruptuar.

Figura 74: Vlerësimi i korrupsionit nga të anketuarit të cilët kanë pasur kontakt me të paktën një institucion






Figura 75: Vlerësimi i korrupsionit nga të anketuarit të cilët nuk kanë pasur kontakt me një institucion



Pas dhënies së vlerësimit të tyre për çdo institucion, të anketuarve ju kërkua të shpjegonin burimin e tyre të informacionit prej të cilit ata krijuan opinionin e tyre, gjë që lejonte për shumë përgjigje. Pjesa më e madhe e të anketuarve e bazuan vlerësimin e tyre në diskutimet që kanë bërë me miqtë, familjen dhe të afërm; informacioni nga mediat është gjithashtu një burim tjetër i rëndësishëm, ndërsa përvoja personale vjen në të tretin. Siç u tha më parë, perceptimi i përgjithshëm rreth korrupsionit ka një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e korrupsionit, i cili siç tregohet, luan një rol më të rëndësishëm sesa përvoja personale.

Figura 76: Ku e bazoni vlerësimin tuaj për korrupsionin? (lejohen shumë përgjigje)



4.3.3 Përvoja me korrupsionin: gjetjet cilësore

Gjetjet e komponentit cilësor të studimit tregojnë se qytetarët kanë një perceptim të lartë mbi korrupsionin si edhe njohuri lidhur me këtë sjellje korruptive. Por këto fenomene hasen tek disa institucione të veçanta dhe më specifikisht ASHK (më parë ZRPP dhe ALUIZNI), ndërsa gjithashtu rastet e rryshfetit të vogël (për të shmangur radhën) në institucione të tjera si p.sh. ISSH (sikurse vërehet në grupet e diskutimit të Korçës).

“

Patjetër që ka korrupsion. Unë kam eksperiencë të pafundme personale me korrupsionin. Kisha një rast ku sipas ligjit dhe akteve nënligjore specifike, ALUIZNI (tani ASHK) ishte institucioni përgjegjës për ofrimin e procedurës administrative. Por ndonjëherë, kur nëpunësit publikë kuptojnë se ju jeni shumë i informuar për procesin, ata frikësohen. Unë gjykohej për faktin se jam pjesë e një komuniteti të caktuar (Komuniteti Rom).

”

Femër, 28 vjeç, Tiranë, Komuniteti Rom

“

Bazuar në kualifikimet dhe trajnimet e mia mbi anti-korrupsionin, unë mendohej të mendoj në mënyrë kritike në këtë drejtim dhe nuk i pranoj të gjitha opinionet dhe perceptimet e të rinjve mbi korrupsionin. Ne jemi ata që korruptojmë të tjerët për të marrë më shpejt shërbim, që ti bëjmë gjërat tona më shpejt se të tjerët.

”

Mashkull, 27 vjeç, Tiranë, Komuniteti Rom

“

Ju i jepni rryshfet rojës së institucionit (tek ISSH), rreth 200 lekë për të hyrë brenda institucionit. Çdo roje është hapi i parë drejt procesit të marrjes së shërbimit. Nëse ai nuk hap derën e institucionit, atëherë nuk ka vend që ju të hyni brenda.

”

Mashkull, 55 vjeç, Korçë, zonë rurale

“

Kudo që ju shkoni, ka korrupsion. Unë kam dëgjuar raste rryshfeti në ZRPP (tani ASHK).

”

Mashkull, 60 vjeç, Shkodër, zonë rurale

“

Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP tani ASHK) mund të jetë i vetmi institucion që (qëllimisht) lë hapësirë për vonesa dhe gabime (këto situata çojnë në sjellje korruptive). Ende, publiku është përgjithësisht i orientuar për të ndjekur një rrugë ligjore dhe zyrtare.

”

Femër, 23 vjeç, Tiranë, zonë urbane

4. Informacioni dhe Komunikimi

4.4 Përdormi i teknologjisë së informacionit

4.4.1 Aksesit në internet dhe teknologjinë e informacionit

Për të shqyrtuar aksesin në internet dhe teknologjitë e tjera të informacionit, të anketuarit u pyetën fillimisht nëse familja e tyre kishte akses në internet dhe më pas nëse ata kishin një telefon inteligjent. Rezultatet finale tregojnë që në përgjithësi, 67% e të anketuarve kanë një lidhje internet në shtëpi, e cila është 23 pikë përqindje më e lartë në krahasim me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm për të njëjtën çështje.

Sipas indeksit të pasurisë, ka ndryshime domethënëse ndërmjet shtresave të popullsisë. Vetëm 43% e shtresës së varfër deklarojnë se kanë akses në internet në shtëpi, përqindje e cila rritet në 70% për shtresën e mesme dhe 90% për atë të pasur. Në këtë mënyrë, ndryshimi ndërmjet shtresës së varfër dhe asaj të pasur është rreth 47 pikë përqindje.

Figura 77: Aksesit në Internet – krahasimi




Figura 78: Aksesit në internet – sipas indeksit të pasurisë





Figura 79: Aksesit në Internet, Popullsia Rome – krahasimi



Në rastin e Popullsisë Rome, 21.5% e të anketuarve shprehën se kanë një lidhje interneti në shtëpi, e cila është pak më e lartë krahasuar me rezultatet e vlerësimit të ndërmjetëm. Gjithsesi, krahasuar me popullatën e përgjithshme, situata e popullatës Rome nuk ka ndryshuar, pra nuk tregon aspak përmirësim.

Duke marrë parasysh zonën e banimit (Figura 80), 72% e të anketuarve që jetojnë në zonat urbane kanë akses në internet, ndërsa vetëm 60% e të anketuarve që jetojnë në zonat rurale kanë akses në internet, një diferencë prej 12 pikë përqindje mes dy grupeve. Duke i shpërndarë sipas moshës në grupe të vogla, rezultatet reflektojnë një tendencë të qartë, pasi përqindja e të anketuarve që ka akses në internet në shtëpi është më e lartë në grupet më të reja sesa në grupmoshat e moshuara. Për shembull, 84% e të anketuarve të moshës 18-25 vjeç kanë akses në internet në shtëpi, ndërsa vetëm 45% e mbi 64 vjeç kanë akses në internet.

Figura 80: Aksesi në internet – sipas zonës





Figura 81: Aksesi në internet – sipas moshës



Përqindja e të anketuarve që mbajnë një smartphone është disi më e lartë se përqindja e të anketuarve që kanë akses në internet në shtëpi, pasi 78% e tyre deklarojnë të kenë një smartphone. Përqindja është dukshëm më e lartë se në vlerësimin e ndërmjetëm, duke treguar një rritje në numrin e përdoruesve të smartphone me 14 pikë përqindje. Zotërimi i smartphone duket të jetë më i zakonshëm, pasi 59% e shtresave të varfra kanë një të tillë. Megjithatë, përqindja është shumë më e lartë për shtresat e mesme dhe të pasura. Rreth 82% e të intervistuarve të shtresës së mesme kanë një smartphone, ndërsa 95% e shtresave më të pasura kanë një të tillë.

Figura 82: A keni ju një smartphone? – Krahasim




Figura 83: A keni ju një smartphone? –sipas indeksit të pasurisë





Figura 84: A keni ju një smartphone? Popullsia Rome - Krahasim



Përsa i përket popullsisë Rome, 46% e të anketuarve zotërojnë një smartphone, e cila është 10 pikë përqindje më e lartë se në vlerësimin e ndërmjetëm. Edhe pse ky segment i popullsisë nuk ka një lidhje internet në shtëpi, ata ka më shumë mundësi që të kenë akses në internet përmes telefonit të tyre.

Duke parë zonat e banimit, 83% e të anketuarve që jetojnë në zonat urbane kanë një smartphone, dhe nga ana tjetër, 70% e të anketuarve që jetojnë në zonat rurale kanë një, që përbën një ndryshim prej 13 pikë përqindje midis dy grupeve. Të shpërndara sipas moshës, rezultatet tregojnë se ka një përqindje shumë më të lartë të qytetarëve të rinj që kanë një smartphone sesa qytetarët e vjetër, pasi 89% e të anketuarve nën moshën 55 vjeçare kanë një smartphone, ndërsa vetëm 56% e të anketuarve mbi 55 vjeç kanë një të tillë.

Figura 85: A keni ju një smartphone? - sipas zonës së banimit





Figura 86: A keni ju një smartphone? – sipas moshës



4.4.2 Përdorimi i internetit

Rreth 67% e të anketuarve kanë një lidhje interneti në shtëpi (e cila përjashton hyrjen në internet nga smartphone), ndërsa 76% e të anketuarve aktualisht përdorin internetin, qoftë duke e përdorur atë në shtëpi me kompjuterin e tyre ose diku me smartphone e tyre, ose edhe në qendra të internetit (Figura 87). Proporcioni është shumë më i lartë se në vlerësimin e ndërmjetëm, ku 63% e të anketuarve përdorin internetin. Rezultatet e vlerësimit final tregojnë se përdorimi i internetit është shumë më i lartë për shtresat më të pasura në krahasim me shtresat më të varfëra (Figura 88). Vetëm 56% e shtresave më të varfëra përdorin internetin nga çdo pajisje, ndërsa rreth 94% e shtresave më të pasura bëjnë të njëjtën gjë, duke përfshirë një hendek të përdorimit prej 38 pikë përqindje midis dy shtresave. Së fundmi, 80% e shtresës së mesme përdorin internetin, ndërkohë që dallimi midis shtresave më të pasura dhe shtresave të mesme (14 pikë përqindje) është më i ulët se diferenca midis shtresave të mesme dhe shtresave më të varfëra (24 pikë përqindjeje).

Figura 87: A e përdorni internetin? – Krahasim




Figura 88: A e përdorni internetin? – sipas indeksit të pasurisë





Figure 89: A e përdorni internetin ? Popullsia Rome- Krahasim



Rezultatet për popullsinë Rome tregojnë se 44% e të anketuarve përdorin internetin, qoftë duke e përdorur atë në shtëpi me kompjuterin e tyre ose diku me smartphone e tyre, ose edhe në qendra të internetit. Kjo shifër është 11 pikë për qindje më e lartë në krahasim me atë të vlerësimit të ndërmjetëm. Ky rezultat është shumë i ngjashëm me rezultatet e zotërimit të “smartphone” (46% e të anketuarve zotërojnë një “smartphone” - Figura 84), duke sugjeruar që përdorimi i internetit realizohet përmes kësaj metode.

Të anketuarit nga zonat urbane kanë një shkallë më të lartë të përdorimit sesa të anketuarit nga zonat rurale. Më konkretisht, 82% e të anketuarve nga zonat urbane përdorin internetin, ndërsa 68% e të anketuarve nga zonat rurale përdorin internetin. Kur marrin parasysh moshën, të anketuarit në moshat e reja kanë një përdorim më të lartë të internetit se të anketuarit në moshat më të vjetra. Grupmoshat 18-24 vjeç kanë një nivel të përdorimit të internetit deri në 98%, ndërsa deri në moshën 54 vjeçare ekziston përdorimi i internetit rezulton me mbi 50%. Megjithatë, vetëm 43% e grupmoshës mbi moshën 64 vjeç përdorin internetin nga çdo pajisje.

Figura 90: A e përdorni internetin? – Sipas zonës së banimit





Figura 91: A e përdorni internetin? – Sipas moshës



Vetëm ata të anketuar që nuk e përdorin internetin për momentin, u kërkua të shprehnin nëse kanë ndërmend të përdorin internetin në 12 muajt e ardhshëm. Rezultatet përfundimtare tregojnë se vetëm 9% e të anketuarve kishin ndër mend të përdorin internetin në 12 muajt e ardhshëm, ndërkohë që

shumica dërrmuese e 83% nuk deklaruan ndonjë qëllim të tillë (Figura 92). Rezultatet vazhdojnë të jenë pothuajse të njëjta me vlerësimin e ndërmjetëm, në të cilin 10% e të anketuarve deklaruan se nuk kanë ndërmend të përdorin internetin. Duke e ndarë sipas indeksit të pasurisë, sigurisht që janë më shumë të anketuar nga shtresat më të varfëra që nuk përdorin internetin për momentin dhe vetëm 6% prej tyre kanë ndërmend të përdorin internetin në 12 muajt e ardhshëm. Përqindja rritet me 22% në shtresat e mesme dhe 13% për shtresat më të pasura.

Figura 92: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? - Krahasim




Figure 93: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – Sipas indeksit të pasurisë





Figura 94: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? Popullsia Rome - Krahasim



Rezultatet nuk ndryshojnë shumë për popullsinë Rome, pasi 11% e të anketuarve kishin ndërmend të përdornin internetin në 12 muajt e ardhshëm.

Më tej, nuk ekzistojnë ndryshime domethënëse ndërmjet të anketuarve që jetojnë në zonat urbane dhe ato rurale lidhur me qëllimin për të përdorur internetin (Figura 95). Në lidhje me moshën, vërehet që çuditërisht grupmosha 18-24 vjeç ka më pak ndërmend për të përdorur internetin gjatë 12 muajve të ardhshëm, ndërsa ajo rritet në grupmoshën e mesme dhe ulet sërish në grupmoshën me të vjetër të popullsisë.

Figura 95: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – Sipas zonës së banimit







Figura 96: A keni ndërmend të përdorni internetin në 12 muajt e ardhshëm? – Sipas moshës



Shkurtimisht, rezultatet e vlerësimit final tregojnë se shumica e të anketuarve përdorin shërbimet e internetit nga shtëpia, ndërsa ka edhe shumë prej atyre që përdorin internetin në një kafene me Wi-Fi dhe disa që e përdorin atë nga puna e tyre ose nga vende të tjera publike. Situata është e njëjtë në lidhje me të gjitha kategoritë. Kur krahasohet me vlerësimin e ndërmjetëm, rritet përdorimi i internetit në shtëpi, në kafene me Wi-Fi, në vendin e punës dhe në vendet publike.


Figura 97: Ku e përdorni internetin? (Vetëm ata që e përdorin internetin – me shumë përgjigje)





Kur lejon vetëm një përgjigje në mes të alternativave, nuk ka dallim të rëndësishëm nga përgjigjet e shumëfishta. Shumica e të anketuarve përdorin internetin nga shtëpia, dhe disa nga të anketuarit e përdorin atë nga kafenetë me Wi-Fi ose edhe nga puna. Rezultatet nuk tregojnë ndonjë ndryshim të konsiderueshëm nga vlerësimi i ndërmjetëm.

Figura 98: Ku e përdorni internetin? (Vetëm ata që e përdorin internetin – me një përgjigje)







